E MËRKURË, 2 NËNTOR 2011 · VITI 3 I BOTIMIT · NR 7 (44) · ÇMIMI 20 LEKË

Nganjëherë historia ka nevojë për një të shtyrë

gazeta

GAZETE E PERJAVSHME - BOTUAR NGA ORGANIZATA POLITIKE, TIRANE

Lexojeni, shpërndajani miqve dhe mbi të gjitha, dorëzojani armikut!

analize 02

(Fund) amentalizmi kapitalist

Kur shqiptarit të zakonshëm i ra në vesh togfjalëshi "terapi shoku", e mori me ...

analize 03

"Occupy" do të thotë zaptim, jo negocim!

Kritika kryesore ndaj lëvizjeve "Occupy" është mungesa e kërkesave të qarta dhe specifike. Në shumë artikuj, opinionistë, analistë e ...

analize 05

NJE BOTE PA PADRONË

Kur në vitin '99 protestat anti-globaliste në Siatëll mobilizuan qindra mijra njerëz kundra formave shfrytëzuese të kapitalizmit, të gjithë analistët "serioz" e panë këtë shpërthim si një trill rinor. Analiza të pafundme socio-...

zizek 08

NË MBROJTJE TË KAUZAVE TË HUMBURA V

Duhet me pasë kujdes kur kundërshtarët nisin të flasin të njëjtën gjuhë apo të bashkëndajnë të njëjtën premisë – kjo pikë e bashkëndarë është zakonisht pika e tyre simptomatike...

opinion 14

REGJIM ME SAKTËSI SNAJPERI

Dy prej katër viktimave të 21 Janarit u qëlluan me armë preçizioni! Ndërsa nën breshërinë e armëve të gardës humbën jetën dy dhe u plagosen rreth njëqind të tjerë. Shumë prej tyre u mjekuan në shtëpi, jo sepse spitalet nuk ofrojnë higjenë dhe ...

KAPITALIZËM!

Editorial

Ç'TË BËJMË?

Nëpër filmat aksion të qëmotit, një prej mbylljeve më të zakonshme ishte ajo e një treni, që pasi heroi dhe viktimat kishin shpëtuar duke u hedhur në çastin e duhur, tëposhtej me të këqijtë brenda në humnerën nën urën-hekurudhore. Kështu që teleshikuesi të merrte frymë lirisht për vënien e drejtësisë në vend përmes zjarrit gjithëpërpirës të ndëshkimit të keqbërësit. Prej shekujsh, kapitalizmi e ka marrë timonin e trenit të historisë, dhe përkundër shpresave mesianike të arritjes në stacionin e bollëkut, po i afrohet dita-ditës humnerës së kolapsit ekonomik, rrënimit shoqëror, varfërisë pandemike, formave të reja të përjashtimit e racizmit, tëhuajsimit njerëzor, autoritarizmit politik e formave të kamufluara të fashizmit të butë. Veçse ndryshe nga trillet kinematografike, këtu shpëtimtari nuk ekziston, timonierët kërcejnë jashtë para zgripit e popujt i pret humnera. Humnerosja kapitaliste globale s'lë mënjanë asnjë element të tij, e aq më pak Shqipërinë e gjunjëzuar ndaj çdo forme shfrytëzimi e sundimi. Në hierarkinë globale të ndarjes së punëve, më shumë e më egër se kudo, shqiptarët kërcënohen nga mjerimi që sa herë duket se gjen fundin përtej të cilit zor se mbijetohet, e merr lopatën e gërmon për ta hapur pafundësisht gropën. Këtu jo vetëm s'ka punë masivisht, ushqim të mjaftueshëm, shërbim shëndetësor minimal, arsim emancipues etj, por së fundi integrimi në tregun global të plehrave do na "nderojë" me detyrën e kancerozit. E si në batutat e filmave Western, ku kaubojsi i thërret tjetrit para duelit "Kufomë që ecën", shqiptarët do të shënojnë kategorinë e re njerëzore: atë të qenieve tragjikisht piktoreske prej kureshtjes që ngjallin kufomat që ecin.

Në këto kushte, e vetmja pyetje politike emancipuese është "Ç'të bëjmë?". Përgjigjja vjen nga anekënd bota: Organizim politik. Pushtim (çlirim) i hapësirës publike. Refuzim masiv. Jo ndërgjegjësim "civilist" që e dënon shqiptarin në bëzatje momentale të plogët, por emancipim politik përmes bashkëndarjes së çastpasçastshme të vuajtjeve e shpresave, mendimit e veprimit, kritikës së asaj që ndodh e imagjinatës së botës së re, e mbi të gjitha guximit për ta menduar e sjellë në jetë të renë. Guximit për të dalë nga cikli shtazor i pësimit të gjithçkaje, guximit për të rrezikuar e fituar. Guximit për të pranuar se shpëtimtari nuk ekziston. Populli është shpëtimtari i vetvetes. Pra guximit për të qenë politikisht popull.

gazeta
E mërkurë, 2 Nëntor 2011

(Fund)amentalizmi kapitalist

Arlind Qori

Kur shqiptarit të zakonshëm i ra në vesh togfjalëshi ‘‘terapi shoku’’, e mori me frymëmarrje lehtësuese ankthin e kapërcimit të panjohur ekonomik. Në fund të fundit, kapitalizmi qenkësh punë ‘‘shoqnie’’ e ‘‘terapia e shokut’’ duhej t’i ngjasonte borxhit mes shokësh te drama ‘‘Komunistët’’, ku borxhdhënësi i thotë borxhliut: - Paret, kur t’i kesh me thasë, do mi kthesh me grushte. Historia shkoi ndryshe e shqiptari i zakonshëm kuptoi si i papunë, i papronë, i pa-të-ardhme, i pa-atdhe se ‘‘shoku’’ i ri i ngjante ‘‘shokut’’ të sapopërmbysur: të dy pretendonin të përdornin elektroshokun për të ringjallur pacientin, por në të vërtetë përdornin armën neuroparalizuese për të fashitur rezistencën: i pari ndaj monopolit pushtetor, i dyti ndaj plaçkitjes së organizuar.

S’ka Zot tjetër veç kapitalit dhe qeveria është e dërguara e tij!

Sa herë themi fundamentalizëm, e para gjë që na vjen ndër mend është feja. Në të vërtetë, fundamentalizmi mund të përkufizohet krejt laikisht për të përfshirë një tërësi bindjesh dogmatike, vetëreferuese, jokritike, gjithëshpjeguese, mesianike etj, që në sferën politiko-ekonomike nuk synojnë afrimin me Zotin nëpërmjet gërmimit për të gjetur rrënjën autentike të besimit, por sundimin e shoqërisë në emër të një teorie të kulluar. Kështu, kapitalizmi përmbledh gërshetimin e një qasjeje ekonomike që mbështetet tek privatizimi thuajse total, shenjtëria e pronës private (pavarësisht origjinës e pasojave të saj), këmbimi tregtar i gjithçkaje me gjithçka, me çdo çmim a sakrificë, zhdukja përshkallëzuese e shërbimeve sociale, himnizimi i pabarazive, kuptimi i lirisë si liri tregu apo zgjedhjeje (megjithëse në kushte shoqërore të pazgjedhura nga ata që u thuhet se tashmë kanë mundësi të zgjedhin), me një qasje politike që e sheh shtetin vetëm si instrument dhune në shërbim të të mësipërmeve. Kështu, tregu apo kapitalizmi fetishizohet duke u shndërruar në Zotin e gjithëfuqishëm e dashamirës që me duart e të dërguarve të vet ngjall të vdekurit nga varri (s’përbën habi termi që përdorin idhtarët e kapitalizmit: ringjallje ekonomike. Kupto: elektroshoku kapitalist ngjall të vdekurën ekonomi).

Në konkretësinë tonë, Zoti-Kapital pret të dërguarit e tij. Garën e të devotshmëve duket sikur e ka fituar qeveria aktuale, jo vetëm pse Berisha ka më shumë vite në fron, por edhe sepse për çdo herë dëshmon devotshmëri më autentike e këmbëngulëse se konkurrentët e djeshëm e të sotëm. Për të mos kujtuar shpronësimin dy-lekësh të shqiptarëve duke i shpronësuar nga e përbashkëta e krijuar nën një regjim tiranik, duke krijuar njëkohësisht bërthamat e pasunarëve të rinj dhe ushtrinë e të papunëve e të mjerëve ciklikë, mjafton të sjellim në vëmendje ‘‘shoket’’ e radhës: (1) atë të rrënimit të arsimit universitar publik nëpërmjet një ligji në prag miratimi, i cili fare hapur do të financojë universitetet private nga buxheti i shtetit, duke mpakur njëkohësisht financimin e universiteteve publike. Shkollimi universitar nga e drejtë universale do të kthehet në luks që shijohet nga ata që përditë janë më të paktë në numër, por gjithsesi më të fryrë në xhepa. (2) atë të ‘‘integrimit’’ të Shqipërisë në tregun global të plehrave, ku kuptohet që roli ynë nuk do

të jetë as prodhimi i makinerive përpunuese, as ai i krijimit të industrive që pas përpunimit marrin si lëndë të parë atë çka prodhohet, por thjesht ai i kazanit të madh ku ‘‘vlon’’ gjithçka e mbytet gjithkush. S’duhet harruar se në ndarjen ndërkombëtare të punës ka punë për të gjithë: ne do të zëmë vendin e kancerobartësve. Në fund të fundit, punë është edhe kjo. Do rrojmë më pak, por ama ca lekë nga taksat do t’i marrim e do të ndërtojmë rrugë, qoftë edhe autostradë për në varreza!

S’ju pëlqen? Punë e madhe! E kërkon tregu. Për fundamentalistët nuk është e mira që i paraprin Zotit, çka do ta bënte këtë të fundit të gjykueshëm, por Zoti që i paraprin të mirës. Ajo çka Zoti shpreh me gojën e të dërguarës të vet përbën të vërtetën e kryevlerën. Kështu që çështja nuk shtrohet politikisht nëse duhet apo jo, por meqë është e vetëkuptueshme që duhet, pyetja që duhet shtruar është: si ta ndërtojmë më shpejt? – kuptohet, autostradën për në varreza.

Trinia e problemit: mohim-zvogëlim-dëshpërimi

Kur fundamentalizmi kapitalist ndeshet me shkatërrimtarinë e vet, si në rastin e krizës aktuale të kapitalizmit në rrafsh global (gjë që s’ka si ta shmangë Shqipërinë, sa kohë në katundin global vala e lumit i merr të gjithë, pavarësisht nga pozicioni i shtëpisë), përgjigjja ndjek tre etapa. E para dhe më e zakonshmja është mohimi i pasojave të saj. Kjo ndodh sidomos kur shkatërrimtaria nuk ka arritur pikën e krizës paniksjellëse, por thjesht segregacionin e pakicave të tejvarfëra të lumpenëve të getoizuar të kudogjendur në kohë e hapësirë. Madje edhe më të mjerë ngjajnë ata në metropolet perëndimore, ku në vargjet e Kadaresë ‘‘Janë të dhimbshëm gjithkund të verbrit/ Por të tillë ngjajnë më shumë në Paris’’, mjafton të këmbejmë ‘‘të verbrit’’ me ‘‘të varfrit’’ apo Parisin me çdo kryeqendër tjetër. Në rast se në Perëndim të varfrit e segreguar gjatë bumit të fundit kapitalist përbënin 10 % e të mallkuarve që mund të fshiheshin para turbo-shpenzimeve mirëqenëse të ‘‘mediokërve’’ (d.m.th. klasës së mesme) me para të marra borxh përmes shtysës së ethshme të kreditimit, në rastin shqiptar të mallkuarit gjithnjë kanë përbërë shumicën..., por të heshtur ama. E për pasojë, fakti që midis elitës dhe të mallkuarve gjendej një shtresë tampon funksionarësh apo ‘‘të rregulluarish’’ të njëfarësojshëm, dhe mbi të gjitha fakti që këta të fundit zakonisht zotëronin privilegjin e të qenit të arsimuar apo ndërgjegjësuar aq sa për të artikuluar kërkesat apo problematikën e tyre, bënte që mjerimi i rrethinave të mohohej fare lehtë. Në fund të fundit, kur nuk ankohet ojf-isti, zyrtaruci apo dyqanxhiu... krisma s’ka pasur. Edhe në keni dëgjuar, ato janë atje larg. Në gjirin e shpellarëve që vriten mes vedi për shkak të pagdhendjes, e jo për shkak të mjerimit!

Etapa e dytë e qasjes ndaj problemit gjendet në zvogëlimin e tij. Diçka e tillë po ndodh aktualisht në Perëndim. Meqenëse kriza ka goditur shtresat e mesme, atëherë s’ka si të mos pranohet se diçka nuk shkon. Gjithsesi, fundamentalizmi përpiqet jo vetëm t’i zvogëlojë përmasat e krizës, por mbi të gjitha t’i kuptojë ato jo si defekte të krijuara nga vetë sistemi e të pakapërcyeshme brenda tij, por si disfunksione të përkohshme, që herët a vonë do t’i rihapin rrugën mrekullisë ekonomike. Në rastin tonë, faza e zvogëlimit ndihet në ligjërimin qeveritar i cili pas entuziazmit të shfrenuar të rritjes dy shifrore, tërhiqet faktikisht duke pohuar se kemi ca probleme të vogla të cilat nuk është se po na bëjnë më të varfër, por për shkak të krizës globale, po na ngadalësojnë paksa hapin e pasurimit.

Etapa e tretë është ajo e dëshpërimit apo fatalitetit. Kjo ndodh kur në momente kthjelltësie zëra nga gjiri fundamentalist dalin hapur e pranojnë se kapitalizmi si i tillë e ka të pamundur të realizojë ëndrrën e mirëqenies për të gjithë, veçse...çdo tentativë përmbysëse-revolucionare jo vetëm që do ta përkeqësonte situatën ekonomike, por mbi të gjitha do t’i çelte portën gogolit totalitar. Ky qëndrim ndihet aty-këtu në Perëndim e pritet të theksohet me përkeqësimin e krizës pasi përbën mjegullën mbrojtëse ideologjike ndaj përpjekjeve politike emancipuese. Më i fortë do të jetë një reagim i tillë në Shqipëri ku boria propagandistike ka krijuar një farë refleksi të kushtëzuar pavllovian sipas të cilit sa herë dëgjohet fjala barazi apo drejtësi shoqërore, mendja shkon menjëherë në burgun e Spaçit.

I gjetëm sabotatorët!

Kur përballet me krizën, fundamentalizmi kapitalist në vend të pranimit të shkaqeve strukturore të saj, e gjen fajin tek elementet rrethanore e dytësore të sistemit. Për sa kohë sistemi është i kulluar në teori, atëherë përgjegjës për falimentimin e tij bëhen disa prej aktorëve kyçë të tij. Kështu, në SHBA qasja më e zakonshme ndaj krizës aktuale është ajo e damkosjes së disa spekulantëve të veçantë, grykësia apo aventurizmi i të cilëve shkaktoi rrënimin e sistemit financiar, apo të ndonjë shoqërie konspirative djallëzore që prej një vendi të fshehtë komandon botën. Sigurisht që fshikullimi i spekulantëve ngroh zemra e vë në vend një farë drejtësie, por ajo që pohohet herë hapur e herë nën zë është se kapitalizmi ende përbën përgjigjen, mjafton që të shmangen turbullirat spekulative. Kështu që vendin e sabotatorit të stalinizmit, ekzistenca e të cilit shërbente pikë justifikuese për dështimet e sistemit, e zënë spekulantët apo çifutëria botërore.Në rastin shqiptar, ngjashëm si në vende të tjera lindore, dështimi i kapitalizmit fshihet pas një vetëracizmi kulturor. Kështu që fajtori këtu gjendet lehtë. Nuk është as terapia e shokut, as privatizimet totale, as ulja e taksave për oligarkët, por pandreqshmëria gati gjenetike e shqiptarëve. Pra ne, batakçinjtë e pandreqshëm, që brez pas brezi ngrohemi në diell, pimë raki e rrahim gruan e kalamajtë, e jo si dojçët që eksitohen nga puna, jemi fajtorët e djeshëm, të sotëm e të nesërm. Çka tregon se shtypja e nënshtrimi i strukturës ekonomiko-politike përgjatë dhjetëvjeçarëve ka sjellë si pasojë përbrendësimin e problemit në rrafshin identitar. Prandaj çdo tentativë kritike ndaj kapitalizmit apo politikë emancipuese përballet me dorëzimin pa kushte të pohimit: po ku kena për tu bo no nji her’ ne shqiptarët!, e për pasojë të atij tjetrit: si s’po na pushto njeri që të shpëtojmë!

Mesia ka me ardhë! Deri atëherë...gërmoni, gërmoni!

Fundamentalizmi kapitalist e interpreton mjerimin e politikave të veta si sakrificë të domosdoshme në rrugën e shëlbimit. Teoricienët e terapisë së shokut rëndom i shpjegonin dështimet e tyre nëpërmjet tezës se tronditja e domosdoshme që duhet të pësojë ekonomia e një vendi në afatshkurtër mund të sjellë pasoja të rënda si p.sh. papunësi masive, ngritje çmimesh apo vendnumërim pagash. Gjithsesi, në një të ardhme të papërcaktuar mirëfilli efektet parajsore do të ndihen medoemos. E meqë të tilla efekte s’duken në horizont, atëherë duhet shtyrë tutje vija e horizontit se një ditë, e lum ne për atë ditë!, askush s’ka me qenë i varfër pasi tregu do të ketë vetërregulluar gjithçka. E në pritje të Mesisë, detyrë e çdo vendimmarrësi është të gërmojë deri në rrënjët e recetës ekonomike, për ta kulluar qasjen kapitaliste nga papastërtitë e ndërhyrjes shtetërore. Kështu që ngjashëm më fundamentalistët fetarë që problemin e shohin tek mungesa e besimit të kulluar dhe shpëtimin e gjejnë tek shkuarja te rrënjët e besimit, fundamentalistët kapitalistë problemin e shohin tek largimi nga burimi i kulluar i recetave të tregut, e për pasojë zgjidhjen e presin tek kullimi i kapitalizmit autentik.

Zoti vdiq! Rroftë Zoti...apo...?

Pavarësisht besimit të patundur fundamentalist, Zoti kapitalist po vdes. Lajm i mirë apo jo? Mbase edhe jo. Ose më saktë, lajm i mirë me kushtin që...Ajo çka po vdes nuk është kapitalizmi si sistem shfrytëzues, por kapitalizmi si shpresë e mirëqenies masive. Dinamika vetërevolucionuese e kapitalizmit e bën atë sistemin ekonomik më të mbijetueshëm ndaj çdo krize të brendshme. Madje shumëkush mendon se kapitalizmi mbijeton nëpërmjet krizave apo se këto të fundit e forcojnë atë. Gjithsesi ëndrra e kapitalizmin me fytyrë njeriu, d.m.th. kapitalizmit perëndimor të 5-6 dekadave të fundit që gërshetonte mirëqenien masive relative me tolerancën e demokracisë liberale, po vdes nga dita në ditë. Jo vetëm që mirëqenia përbën kujtim të kohërave të arta, por edhe toleranca liberale priret t’i lërë vend autoritarizmit si kundërpërgjigje ndaj rezistencës kundër-sistemore. Në një situatë të tillë, vdekja e Zotit të vjetër kërcënon të kthehet në lindjen e një Zoti të ri, që gjithnjë e më pak do të ketë fytyrë njeriu e që shpresën ideologjike që ngjallte kapitalizmi në ekspansion do ta shndërrojë në frikën ndaj aparateve represive që kalërojnë mbi mbijetesën e kapitalizmit. ‘‘Bota e vjetër po vdes. Bota e re po lufton të lindë. E sotmja është dita e përbindëshave’’ – shkruan Antonio Gramsci. E që kjo të mos ndodhë, bota e re duhet të lindë përmes përpjekjesh politike emancipuese që nuk synojnë ndërrimin e Zotave, por mbartin guximin e të jetuarit pa Zot: të bashkëndarit të problemeve, shtrimit kritik të tyre dhe rishpikjeve të alternativave që lirinë e barazinë e kanë frymëzim në pikënisje e pikëmbërritje, por që në formulimin konkret i ngjanë poetit skrupuloz që mijëra fletë poezie në tentativë i hedh në kosh, deri sa ja mbërrin tek poezia; qetësohet e kënaqet për pak kohë, por shpejt e kupton se s’ia ka arritur qëllimit e ja nis një poezie të dytë...

“Occupy” do të thotë zaptim, jo negocim!

Jona Mersuli

Kritika kryesore ndaj lëvizjeve “Occupy” është mungesa e kërkesave të qarta dhe specifike. Në shumë artikuj, opinionistë, analistë e të ngjashëm të vetëquajtur kështu apo ashtu mbërrijnë në përfundimin tepër profesional: “Ata nuk dinë ç’kërkojnë.” Në një shkëmbim David Brooks dhe Gail Collins, kolumnistë në gazetën “New York Times”, pasi bien dakord se ia vlen të flitet për këtë çështje, meqenëse “detyra jonë si opinionistë është të sjellim në vëmendje se aksh gjëje po i jepet shumë vëmendje”, vënë në dukje numrin e pakët të protestuesve dhe e konsiderojnë lëvizjen si protestë kundër 1% të të pasurve në Amerikë. E më pas nënvizohet prerë se asnjë amerikan nuk i përgjigjet negativisht kërkesës për të bërë sa më shumë para.

Së pari, duket qartë se qasja e tyre e analizës ka natyrë krejtësisht sasiore (vëmendja, sa është numri i protestuesve, amerikanët duan të bëjnë shumë para). Kjo këndqasje e bën të pamundur vlerësimin e lëvizjeve “Occupy”, natyra e të cilave e kundërshton këtë diskurs. Si të thuash, analistët në fjalë vlerësojnë lëvizjen përmes mjeteve që kjo lëvizje refuzon. Kjo çarje, jo vetëm metodike, por mbi të gjitha konceptuale e zhvlerëson tërësisht këtë lloj pikëpamje, sipas të cilës lëvizja konsiderohet përmes asaj që lëvizja do të ndryshojë, përmes asaj që lëvizja nuk është. Lëvizja “Occupy” nuk mund të vlerësohet nga logjika e 1 përqindëshit, kur ajo kërkon ndryshimin radikal të kësaj logjike.

Së dyti, kjo të kujton tezën e vjetër, sipas të cilës në rast se kritika nuk pasohet nga një propozim i menjëhershëm, nuk është më e vlefshme. “Kapitalizmi është sistemi më i mirë i mundshëm”. Kaq shumë është thënë e stërthënë kjo frazë, sa përveç sinonimisë a përnjështimit shqetësues që vendoset mes kapitalizmit dhe demokracisë, krijohet një farë parakushti, pas të cilit meqë nuk ka propozim tjetër efikas, efiçent, etj. etj., kritika është vetëm zemërimi i ca njerëzve “që nuk kanë aq para sa do të donin”. Sërish, përballemi me të njëjtin problem: propozimi kërkohet nga dhe me premisat e kapitalizmit. Arsyet e zemëratës së këtyre njerëzve mund të jenë vetëm arsye që gjejnë kuptim brenda sistemit kapitalist. Si të thuash, terminologjia thellësisht kapitaliste (efiçent, efikas, fitimprurës) pavarësohet nga sistemi brenda të cilit fiton kuptim dhe mëton të bëhet kriter vlerësues i pavarur. Ndërkohë që si e tillë (terminologji), ajo nuk mundet – nuk ka se si - të gjejë përgjigje jashtë realitetit prej nga ku prodhohet.

Është interesante se si fjalia legjendare “Kapitalizmi është sistemi më i mirë.” është zëvendësuar nga versioni “Kapitalizmi është sistemi më i mirë i mundshëm.”. Duket sikur ky kalim sugjeron relativizmin e pohimit, pra ky i fundit vendoset në një kornizë mundësish, por në fakt riforcon absolutizmin që kapitalizmi i njeh vetes, sepse thekson pamundësinë e funksionimit të çdo sistemi tjetër. “Më i mirë i mundshëm”, pra ky e s’ka tjetër. Përveçse imponon realitetin, përpiqet të imponojë edhe mundshmërinë. Ose më saktë, pamundshmërinë. Ndryshe nga ç’duket, vendosja e kornizës së mundësive, nuk e bën më pak absolut pretendimin, përkundrazi fusha e tij e shtrirjes shkon deri te raporti e mundur - e pamundur. Kështu, kapitalizmi e ushqen vetveten me reformime tektuke që gjithsesi nuk prekin thelbin – kjo, sepse nuk ka mundësi! Përmes të së ashtuquajturës aftësi reformuese, ai vetë-prezantohet si elastik, efikas, efiçent etj etj., ndërkohë që monizmi i tij qëndron pikërisht në faktin se ai vlerëson vetveten me matës të shpikur nga po ai vetë, duke mos lejuar kështu asnjë kundërvënie nga jashtë sistemit të tij; dhe çdo kundërvënie nga brenda sistemit është vetëm rigjallërim i tij. Çfarë mund të duket si pluralitet elastik është në fakt monizëm i fshehur, i shpërndarë dhe tepër i sofistikuar.

Lëvizjet “Occupy” e kundërshtojnë këtë sistem nga jashtë, jo nga brenda; prandaj nuk mund të analizohen prej perspektivës kapitaliste. Duke e kundërshtuar nga jashtë, pohojnë mundshmërinë e këtij akti. Për këtë arsye, propozimet dhe kërkesat e protestuesve nuk janë “të qarta” dhe “specifike” për z. Brooks dhe z. Collins. Janë kërkesa që vijnë nga jashtë sistemit. Këtë thotë George Machado, protestues në New York, në një video për “The Guardian” “Arsyeja pse ne nuk kemi kërkesa? Nuk mund të kesh kërkesa në një sistem që është tërësisht i thyer. Duhet të ndërtojmë një sistem të ri.” Edhe listimi i 13 kërkesave nga ana e protestuesve nuk është “qartësim” apo “specifikim” i pyetjes “Çfarë kërkojnë këta?”, por vetëm shtjellim i idesë qendrore që bashkëndajnë të gjithë protestuesit e lëvizjeve “Occupy”. Kjo ide nuk gjendet në fjalorin e kapitalizmit, e për rrjedhojë nuk mund të gjejë kuptim brenda logjikës së tij. “Occupy”, siç sugjeron vetë emri, është zaptim. Qartazi, kjo nuk është situatë e njohur – pra e kontrollueshme, pasi nuk është kërkesë për negocim. Është mirëfilltazi zaptim.

Së treti, në disa artikuj “dashamirës e mirëkuptues”, burra të moçëm e të nderuar, justifikojnë mungesën e kërkesave, duke nënvizuar moshën e re të protestuesve, çka parakupton paaftësinë e tyre për të bërë analiza të thella të ekonomisë, politikës etj etj. Nuk është aspak e nevojshme që dikush të ketë lexuar Friedman-in apo Hayek-un, të njohë mirë sistemin bankar dhe të ketë disa mastera e doktoratura në çështjet e politikave ekonomike që të mund të kundërshtojë sistemin në fjalë. Kushdo mund të kuptojë dështimin – jo krizën – e kapitalizmit thjesht dhe vetëm përmes përditshmërisë së tij/saj apo të të njohurve përreth. Një student mund ta kuptojë këtë vetëm duke parë çmimin e shkollimit; një i moshuar duke paguar çmimin e shëndetësisë, një i papunë duke mbijetuar me/pa të ashtuquajturën pagë minimale e me radhë. Protestuesit e lëvizjes “Occupy” i kanë parë këto dhe po kundërshtojnë. Kaq e thjeshtë është.

Në fund, duke perifrazuar një prej protestuesve “Nuk ka se si të ketë kërkesa, pasi kërkesat nënkuptojnë një palë që do të përgjigjet”. Në këtë rast, lëvizja nuk i drejtohet kujt tjetër; lëvizja e kundërshton këtë tjetër. Të nderuar z. Brooks dhe z. Collins , korporatistë, drejtues bankash apo/dhe politikanë, ky nuk është rasti. Askush nuk po ju pyet. Po ju zaptojnë!

gazeta
E mërkurë, 2 Nëntor 2011

Çdo gjë vije në dyshim, por mos guxo me Kapitalizmin

Andi Kananaj

Fytyrat e lodhura e të dëshpëruara të agjentëve të bursës, revoltat nga ato të paorganizuarat të Londrës e deri dhe "pushtimet" e organizuara të territoreve, ku rezistenca e protestuesve duket se është e qëndrueshme, gjenden përkrah në lajmet e huaja.

Ndoshta sepse nuk lexojmë shpesh gazeta të huaja, ose sepse ndoshta besojmë me mbi-ndërgjegje se nuk duhet të interesohemi për lajmet e të tjerëve (se ata fundja e kanë në terezi), fotot që dokumentojnë realitetin në fjalë, nuk na kanë përcjellë asnjë informacion të vlefshëm.

Ndoshta janë vendosur në mënyrë naive krah më krah, por përveç paralelizmit në kohë, duket se pamjet përcjellin dhe dyshimin e arsyeshëm se "diçka" nuk po shkon në ekonominë botërore. Bursa tanimë ngjan si orë e prishur - thotë Berluskoni. Situata e Greqisë, ajo e Italisë, Spanjës, Portugalisë, tregojnë se "biznesi" dhe "tregu" nuk po ecin me hapin e duhur, me hapin e filmave me Las Vegas. Nga ana tjetër, edhe vende si Anglia, pavarësisht se nuk kanë filluar t'i bien këmbanave, nuk duket se po kuptojnë realisht se çfarë po ndodh me tregun. Teoritë liberale duket se kanë prekur fundin e tyre, që deri dje të paktën, nëse marrim si bazë çfarë dëgjonim në Tv, ishin të paimagjinueshme si të tilla.

Liderët botërorë nuk gjetën mënyrë më të mirë për ta mbrojtur sistemin e tyre dhe pushtetin që buron kaq natyrshëm prej tij, veçse duke akuzuar protestuesit si të çmendur, si përfitues nga situata. Në Itali, klasa politike vrapoi të distancohej nga Black Blocks. A thua se dikush po i akuzonte se ata ishin të ngjashëm. Sigurisht që diferenca është kaq e madhe sa askush nuk do të guxonte t'i vinte bashkë as për shaka. Politikanët kudo në perëndim tentuan të gjenin të paarsyeshmen në reagimet e të rinjve agresivë.

Logjika e mospranimit të arsyeve të atyre që po protestojnë, duket se funksionon edhe në Shqipëri. Minatorët protestuan për gati 60 ditë, po gjithkush vrapoi të kuptonte se kush qëndronte pas kësaj lëvizjeje. Më vjen natyrshëm pyetja, se sa minatorë duhet ende të vdesin që të kuptohet se vuajtja e tyre është e vërtetë.

Sado të luhet me enigmën e revoltave paradoksale, sado të tentohet të krijohet besimi se ata që po ngrihen janë të paarsyeshëm, arsyet përtej kësaj logjike janë të shumta.

Sado që zyrat për shtyp të krijojnë deklarata për shtyp cinike dhe inteligjente, sado që kryeministrat e ndryshëm të tentojnë si klouna mediatikë të deformojnë realitetin e të luajnë mbi teori konspiracioni, fakt është që një fashë gjithmonë e më e gjerë njerëzish, po jetojnë keq. Deklasimi dhe hedhja drejt shtresave më të varfra të një grupi në rritje personash e familjesh po kthehet në trend dhe sinjalet tregojnë se e ardhmja do jetë e konsoliduar në këtë drejtim.

Qeveria shqiptare, e cila ka zgjedhur të jetojë në Mars, me anë të teknologjisë na përcjell mesazhin konstant se situata është nën kontroll, edhe pse situata në Tokë është disi më ndryshe.

Për të varfrit në Shqipëri nuk para ka spitale. Edhe në ato pak raste që ka, nuk kanë mjete për t'i shëruar. Pas dere gjenden vetëm mjekë që përpiqen të të mësojnë se si të komunikosh me murin, ta paguash atë, e në fund të falesh tek Zoti që nga ana e tij do të kërkojë pjesën e vet.

Në Shqipëri për të varfrit nuk ka drejtësi. Aksesi në Gjykatë është i pamundur, duke qenë se duhet të paguash një taksë që shkon sa dyfishi i asaj që përfiton nga asistenca sociale. Rreth 430 mijë shqiptarë as një teori nuk e arrijnë deri tek dyert e Gjykatës. Në praktikë kam frikë së numri është më i lartë. Ndërkohë po marrim leksione mbi ekonominë financiare që dukshëm është e ndryshme nga ekonomia e të përditshmes.

Duket se ne nuk jemi populli i Dow Jones, por jemi klasa që paguan për gabimet e Bursës.

Kjo pjesë e shoqërisë kur reagon, përballet me cinizmin e pushtetit, duke krijuar qartë një linjë ndarjeje. Shoqëria që distancohet nga reagimi i dhunës dhe ajo tjetra që po reagon pavarësisht distancimit të klasës në pushtet. Demokratët pasi vranë disa demonstrues i trajtuan ata si puçistë. Socialistët nuk u dolën përkrah duke krijuar një kufi imagjinar mes tyre dhe protestuesve të dhunshëm. Në Shqipëri nuk po i bashkohemi protestave që kanë filluar kundër sistemit, ngaqë tek çdo qytetar shqiptar është krijuar kompleksi i të qenit i trajtuar si nënklasë, si anëtar i grupit të dhunshëm, pjesëtarë agresivë të një shoqërie të distancuar.

Kush pranon dhunën është njëfarësoj shkaktues i këtij turpi të madh. Por çfarë kërkuan me aq energji protestuesit në 21 janar? Kërkuan drejtësi



sociale. Kërkuan që nga sistem i dështuar të realizohej aq sa ishte deklaruar edhe në paktin e madh, në Kushtetutë. Të gjithë të barabartë përpara ligjit. Jo si Ilir Meta, jo si Mediu. Në mënyrë evidente sistemi nuk realizon dot as minimumin e drejtësisë sociale, për të cilën është e detyruar qoftë dhe sa për sy e faqe. Në fakt u arrestuan të paarsyeshmit që protestuan përpara Kryeministrisë. 4 prej tyre u ekzekutuan gjithashtu publikisht, në sheshin përpara fytyrës së pushtetit, duke zhdukur iluzion për një sistem funksional. Pse reaguan protestuesit me aq forcë? Ndoshta sepse po jetojnë jetën në kushte mizerabël? Sepse arrijnë të shohin se qeveritarët e tyre janë të paprekshëm? Apo ndoshta se janë të çmendur, tezë që nuk ka pse të mohohet.

Të arrestuarit dhe jo të arrestuarit e protestës në Londër, Romë, apo Tiranën e 21 janarit (i vetmi moment për t'u marrë në analizë) ishin të pa shkolluar, të shkolluar, të rinj, në gjysëm moshë, të moshuar. Gjithçka që i lidh këto varietete gjinish, arsimimi, apo kohëzgjatjeje në Tokë, është fakti se janë jashtë sistemit realisht. CV-të e tyre tregojnë qartë se përtej kompozimit social qëndron e vërteta e tyre ekonomike. Megjithëse kjo është përdorur në kushtet e deklaratave politike për të mbushur hapësirën televizive të propagandës, kjo shtesë ekziston. Jo NOMINALISHT. Ekziston në të përditshmen e shumicës së shqiptarëve dhe jo vetëm.

Varfëria kthen në aspak social takimin me shtetin. Ndaj në zyrat e tij qytetarët janë nervoz. Përplasja nuk ka estetikën e një rendez vu-je. Qytetarët që reagojnë kanë eksperiencën jo vetëm të papunësisë, por edhe atë të të nën-shpërblyerve, me rroga të pamjaftueshme. Dhuna nuk drejtohej me qëllimin që dikush tjetër të merrte pushtetin, dhuna kishte si tabelë qitje-je jetën e keqe.

Sado që t'i shmangemi fluksit mediatik, jetojmë në kohën e spektaklit të konsumit. Në momentin që nuk i ke sendet që sheh rreth teje, instinktet zgjohen. Fakti që rreth teje ka bollëk mallrash sot shitet si gjendje pozitive, që është dhe diferenca me sistemin e gabuar që sapo lamë pas krahëve. Spektakli i mallrave ngjall instinkte që shkaktojnë vetëm dhunë mbi psikën tonë. Refleksi i Pavllovit duket tek fytyrat pas xhamave të dyqaneve të rrugëve plot me të tillë. Sistemi duke rritur dëshirën për të blerë, ka ndezur motorët e pandalshëm të konsumit në mendjet e njerëzve. Ky ritëm do të çojë në pamundësi për ta realizuar kërkesën e nxitur më çdo mjet të mundshëm. Ka arsye pse njerëzit nuk janë të kënaqur me gjerat e thjeshta. Instikti është ndezur dhe askush s'e ka antidotin për ta ndalur motorin e urisë për mallra.

Qeveritë dhe justifikimet e tyre

Koha e justifikimit, shprehjet "Mos mendo se çfarë do të bëjë atdheu yt për ty por çfarë do të mund të bësh ti për atdheun", habia e përbashkët si shoqëri për dhunën e shoqërisë tjetër, duket se s'do kenë jetë të gjatë edhe për shumë kohë. Sistemi po tregon se nuk është i përkryer se sa u duk në fillim të viteve '90. Çokollatat dhe sapuni luks nuk duket se janë arsyeja pse jetojnë lindorët e Europës së sotme. Shqiptarët duket se do të jenë të fundit edhe në këtë moment historik, siç dhe kanë qenë gjithmonë kur rrota e ngjarjeve ka lëvizur me shpejtësi në drejtimin e përcaktuar nga emancipimi i shoqërive të tjera. Sidoqoftë është çështje kohe dhe mos u habisni kur dhuna të jetë aq madhe sa të trembë çdo përfitues të ditëve të sotme. Dhuna duket se edhe këtë herë do të jetë mjeti i çuarjes përpara të shoqërisë, duke qenë se është e vetmja mënyrë për të shpëtuar nga marrja peng e një sistemi që nuk garanton asgjë të mirë, përveç justifikimeve sa tragjike aq dhe qesharake.

Do të vijë një ditë që edhe pa dashur do ta vëmë në dyshim kapitalizmin, pavarësisht se do të jetë blasfemi po aq e madhe sa shpikja e kondicionerit. Eppur si muove!

NJE BOTE PA PADRONË

LEART KOLA

Kur në vitin '99 protestat anti-globaliste në Siatëll mobilizuan qindra mijra njerëz kundra formave shfrytëzuese të kapitalizmit, të gjithë analistët "serioz" e panë këtë shpërthim si një trill rinor. Analiza të pafundme socio-antropologjike u ndërtuan për të shpjeguar shpërthimin e dhunshëm të protestave antikapitaliste, e sigurisht u risoll në vëmendje dështimi i modelit socialist e forma të tjera të shantazhimit publik, kundrejt atyre që po protestonin kundra varfërisë nën sloganin imagjinativ "një botë tjetër është e mundshme". Megjithatë në atë moment, një botë tjetër e mundshme nuk imagjinohej. Kapitalizmi ishte sërish forma më spektakolare e shprehjes së fetishit të një bote tashmë totalisht konsumeriste. Partitë social demokratike,që udhëhiqnin në shumicën e vendeve kryesore, akoma aso kohe jetonin brenda iluzionit që një "kapitalizëm me fytyrë njerëzore" ishte i mundshëm.

Siatëlli u pasua nga protestat antiglobaliste në Genova, ku përherë e më shumë, po kundërshtohej roli i rëndësishëm i Bankës Botërore dhe FMN, por në përgjithësi i sistemit bankar që po drejtonte botën. Antihumanizmi i kulluar e drejtonte botën, në ato kohë, kur pabarazia ishte totalisht e arsyetueshme, pikërisht sepse ajo ishte koha e boom-it kapitalist. Klasa e mesme po pasurohej simbolikisht përherë e më shumë të stimuluar të blinin shtëpi, makina të reja, gjithçka e krijuar nga kreditë e buta që jepeshin me një lehtësi të jashtëzakonshme nga bankat Europiane e alienuan këtë argument që ulërihej nga të rinjtë në rrugët e rrugicat e Genovës, në komisariatet e policisë ku u torturuan e u masakruan me mijra të rinj.

Cilat ishin kërkesat e tyre? Falja e borxhit ndaj vendeve të botës së tretë, e krijimi i një atmosfere antiraciste në ambjentet e punës, gjithashtu dhe ndërtimi i një shteti social global, si kundërshtim ndaj globalizmit kapitalist. Në atë kohë askush nuk do ta besonte që faktikisht, ajo çfarë po ndodhte me vendet jo të zhvilluara të botës së tretë, të cilat nuk kishin asnjë mundësi progresi për faktin që borxhet që duhet t'i paguanin shteteve "të botes së parë", ishin shumë të larta, situatë e njëjtë do e replikonte veten, kësaj here në mënyrë perverse brenda shteteve të së ashtuquajturës botë e parë, e këtu kemi rastin e Greqisë.

Protesta e Genovës janë një pikë interesante takimi i disa fenomeneve shumë interesante që po ndodhnin në botë në atë kohë. Së pari Genova ishte kulminacioni i mobilizimit të së majtës jashtë parlamentare, që pas 68-ës. Nga ana tjetër ky mobilizim në shumësinë e tij mundohej të sillte në vëmendje shfrytëzimin që i bëhej botës së tretë në dy nivele, në atë shtetëror me masat shtrënguese të pagesës se borxhit të jashtëm e në atë koorporatist me shfrytëzimin e krahut të lirë të punës. Në të njëjtën kohë, në Perëndim bankat dhe fundamentalizmi neo-liberal që kishin adoptuar në ekonomi shumica e perëndimit, po niste të gatuante krizën më të rëndë që ka njohur kapitalizmi global, aty filluan masat ekonomike që prodhuan krizën që ka nisur që prej 2008 e nuk po e ndal dot tatëpjetën. Protesta e Genovës ishte e dhunshme, politika mainstream duke shfrytëzuar dhe rehatinë relative europiane e shkatërroi argumentin ekonomik dhe politik të protestës, duke nxjerrë në pah vetëm pjesën e dhunshme dhe aventuriere që këto grupe kishin ndërmarrë si aksion politik. Pas Genovës ka pak ose aspak organizime globale kundra globalizmit, takimet e tjera të G8-ës u shoqëruan me protesta shumë më të dobëta, dukshëm argumenti i kapitalistëve kishte triumfuar.

Megjithatë në vitin 2008, gjendemi përballë një krize pa fund ekonomike, kësaj here në zemër të kapitalizmit, në Wall Street. Siç do thoshte Slavoj Zizek "drita në fund të tunelit i ngjan më shumë një treni që po të vjen përballë, sesa realisht fundit të tunelit". Përplasja vetëm sa u shty me dy vite, prej entuziazmit të fitores së Obamës, por përplasja ishte e pashmangshme. Kartonët me fjalën magjike "hope", që u mbajtën në duart e milona amerikanëve ato ditë, nuk kishin vlerë monetare për të paguar kreditë e prapambetura të atyre që tashmë kishin humbur vendet e punës, e bashkë me to i ishin sekuestrar shtëpitë e gjithçka që kishin kursyer prej vitesh. Kapitalizmi po hidhte hapat e para për të treguar fytyrën e vërtetë që nuk i ngjante aspak asaj njerëzore. Kriza si për ironi, kapi dy vende më shumë se të tjerat, Amerikën, që e kishte shpikur kapitalizmin bankar, dhe Greqinë që kish shpikur Demokracinë, si për të dhënë nj sinjal që kohët e bukura të demokracisë shoqeruar me sistemin kapitalist ishin në fund të tyre.

Koha e artë e konsumit ka mbaruar, tashmë asnjë ekonomist serioz nuk flet për kapitalizmin si e keqja e domosdoshme, përkundrazi, përherë e më shumë po shihet domosdoshmëria për ta hequr këtë të keqe nga shpatullat e brishta të një popullate që e gjeti veten të mashtruar nga ëndrrat e fabrikuara në zyrat e bankave dhe parlamenteve Perëndimore. Sot protestuesit mbushin sheshet e kryqendrave europiane, për të kërkuar pikërisht ato gjëra që në Genovën e 2001 kërkoheshin për boten e tretë, paradoksalisht nuk ishte bota e tretë që do kishte një të ardhme prej bote të parë, por kjo e fundit që ka tashmë një të ardhme si bota e tretë.

A ËSHTË E MUNDSHME NJË BOTE PA PADRONË?

Pikëpyetja që civilizimi ka përpara vetes, është: Cila është forma e re politiko-ekonomike që do ishte opozita e kësaj që kemi tani, d.m.th. kapitalizmin fundamentalist neoliberal? Po shihet qartë që reformimi i asaj çfarë kemi nuk është shpëtim, e provoj Greqia duke ndryshuar qeveri, e asgjë nuk ndryshoi. Shpejt qeveritë do ndërrojnë në Itali, Francë e ndoshta dhe në Gjermani, por sigurisht që asgjë substanciale nuk do ndryshojë pikërisht, sepse problem është që të gjitha partitë mainstream, janë brenda të njëjtit mentalitet, atij liberal-kapitalist. Në këto kushte bota duhet fillimisht të çlirohet nga padronet politiko-ekonomik, që nuk lënë hapësirë për imagjinatë dhe krijimin e kushteve të reja sociale e politike. Së pari si në çdo revolucion duhen denoncuar paradokset dhe ata që i krijuan këto paradokse që sollën tashmë fundin deklarativ të këtij sistemi. Kreditë që po i jepen Greqisë në këto momente janë një paradoks total, nga njëra anë Franca dhe Gjermania, i japin kredi prej 300mil eurosh ditën tjetër i tregojnë se si t'i shpenzojë këto para, duke i kërkuar që gjysmën e kësaj kredie, Greqia ta shpenzojë për të blerë mallra nga kompanitë gjermane dhe franceze. Në këto kushte imperlializmi franko-gjerman është totalisht i qartë, po aq sa është i qartë dhe mungesa e plotë e sovranitetit që sjellin këto kredi të bankave europiane. Cila është sot e përbashkëta e gjithë vendeve europiane që janë ose jo në Bashkimin Europian, të cilat po përballen me krizën? Cila është historia e përbashkët e Greqisë, Spanjës, Portugalisë e nëse duam këtu mund të fusim dhe Shqipërinë, Kosovën, Serbinë? Ka një fenomen që i bashkon këto vendesh në krizën e tyre, e ai është investimi marramendës që kanë bërë përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit në infrastrukturë. Greqia vendi më i prekur nga kriza ka me mijëra kilometra autostrade luksoze, madje vetëm para pak kohësh në Greqi u ndërtua dhe ura më e gjatë në Europë. Banka Botërore dhe FMN, duke aplikuar në bashkëpunim me qeveritë e këtyre vendeve politikat e tregut të hapur, ka krijuar terrenin për këtë akt kriminal. Pas marrjes së kredive të mëdha nga qeveritë përkatëse, këto para janë investuar në infrastrukturë, në mënyrë që këto para të kalonin sërish në duart e atyre që de fakto e kontrollojnë Bashkimin Europian, korporatave. Në këtë mënyrë paratë e taksapaguesve lokal dhe europian, shkonin menjëherë për vepra pa vizibilitet ekonomik, por që të vetmen arsye të ndërtimit kishin që të riktheheshin këto para në një mënyrë elegante në duart e korporatave të mëdha. Kjo solli dhe sot këtë atmosferë borxhesh të cilat janë marrë nga një elitë politike pa pyetur popullin, e më pas janë ricikluar në duart e korporatave perëndimore.

Në këto kushte popujt jo vetëm që nuk munden, por dhe nuk duhet të ripaguajnë të njëjtat korporata që kësaj here duan të rimarrin paratë nëpërmjet taksave dhe reformave drastike antikrizë që po aplikohen. Akti serioz politik do ishte shpallja si kriminale e këtyre marifeteve të elitave politiko-ekonomike të perëndimit, e futja në burg e të gjithë individëve që e krijuan këtë atmosferë. Kjo do ishte drejtësia e propaganduar gjatë gjithë këtyre viteve, e gjithashtu ky do ishte një catharsis që do mund të çlironte Europën nga prangat e 1% kundra 99%. Ky catharsis, jo vetëm do vinte drejtësinë në vend, por do krijonte kësisoj hapësirën fizike dhe imagjinative për të ndërtuar një botë më të drejtë e më të barabartë.

Popujt e Europës e kanë kuptuar qartë këtë punë, për këtë arsye me miliona janë mobilizuar duke pushtuar sheshet e qyteteve më të mëdha europiane, këtë e kanë kuptuar dhe elitat globale politike, që nuk dinë si të ndajnë fajin, e me kë ta ndajnë atë. Ndoshta është hera e parë në historinë politike moderne ajo që ndodhi me Papandreun në Greqi të cilit opozita ja refuzoj ftesën për të marrë pjesë në një qeveri të shpëtimit kombëtar. Popujt janë të shpëtuar, këto manovra bëhen vetëm që elitat të shpëtojnë veten, por tashmë populli e ka kuptuar këtë lojë që bëhet në kurriz të tyre prej vitesh. Një botë pa padronë po bëhet përherë e më e mundshme, kjo tregon dhe pse padronët përherë e më shumë kanë filluar të kenë frikë. Nëse në shumicën e Europës puna me pak e lakmueshme është të jesh kryeministër në këtë kohë, atëherë ky është një sinjal, që pushteti po e humb arrogance simbolike dhe fetishin me të cilin ushtronte pushtet dhe dhuna mbi popullsinë. E për ta reformuar pak pyetjen e fillimit ndoshta jo vetëm një botë pa padronë është e mundshme, por një botë e jetueshme dhe e vlefshme është vetëm ajo që nuk ka padrone.

gazeta
E mërkurë, 2 Nëntor 2011

Qan për t'u okupuar. Shpirti i nahisë Ballkanine

Artan Sadiku

Sot, kur bota po gdhihet nga ëndrra e keqe neoliberale, kur miliona të indinjuar vërshojnë sheshet dhe rrugët e qyteteve duke shfaqur mospajtimin e tyre të thellë me atë që sot bota ka rezultuar të përfaqësojë, popujt e Ballkanit duket se po flenë. Në këtë gjumë Ballkanik ka dy mundësi: e para që këto popuj të Ballkanit akoma nuk janë trishtuar nga ëndrra botërore neoliberale dhe, e dyta që këto popuj po ëndërrojnë një ëndër krejtësisht të ndryshme nga ajo nga e cila po zgjohen popujt tjerë.

Kapitalizmi neoliberal që në vitet e nëntëdhjeta i pat gjetur popujt Ballkanik fillimisht ne pritje, pastaj në habi dhe shpresë të prolonguar, për të përfunduar si fantazmë nga e cila shumica akoma presin të përmbush premtimin e tij, por që në proces e sipër gjeneron turma të tëra duarbosh e të pashpresë. Si në vendet e ish-Jugosllavisë ashtu edhe në Shqipëri, neoliberalizmi erdhi si një premtim i madh lirie e çlirimi nga sistemet shtypëse, premtim që pa u përkthyer në mirëqenie shoqërore krijoi në hapësirën e 'çliruar' shoqërore një zbrazëtirë hegjemonike të mundësisë së pafund të fjalës së lirë për hir të fjalës së lirë. Kjo liri e shprehjes u bë aq vet-arsyetuese e vet-legjitimuese saqë ia imponoi vetes etikën e barazisë së pretendimeve, si standard shoqëror në vlerësimin e pretendimeve që artikulojnë drejtësinë sociale nga njëra anë dhe atyre që propagojnë garën shtazore për akumulim të kapitalit. Premtimi neoliberal pra, solli lirinë në formën e saj më të përlartësuar, atë të barazisë, por të barazisë formale të pretendimeve, duke pamundësuar fundamentalizimin e barazisë në substancën shoqërore, atë të kushteve materiale të ekzistencës individuale.

Duke qenë se në sistemet e kaluara doktrina e proklamuar zyrtare ishte ajo socialiste e komuniste, në hapësirën e re të zbrazëtirës hegjemonike të barazisë së pretendimeve veçmë ekzistonte parakushti themelor që pretendimet që dallonin nga pretendimi social i ish-sistemeve në Shqipëri e Jugosllavi do të kishin afinitetin e tërheqjes më të madhe. Pretendimi nacionalist, të paktën në shtetet e krijuara nga shpërbërja e Jugosllavisë, kishte epitetin e të qenit jo vetëm një pretendim i ri në krahasim më doktrinën që mbizotëroi këtë federatë për pesëdhjetë vite, por edhe pretendim që pas një gjysmë shtypjes gjysmëshekullore më në fund mund të rishfaqte veten si një hero që i mbijetoi betejave të vështira. E drejta në pronën shoqërore, të drejtave themelore të miliona punëtorëve dhe qasja ndaj shërbimeve publike ishin objektiva simbolike të atakimit të trashëgimisë nga e kaluara, ndaj të cilës nacionalizmi i ri Ballkanik u qas si ndaj një tërësie ideologjike që duhej shkatërruar dhe demoluar, kjo sepse mu në emër të kësaj mirëqenie ishte ndërtuar premisa e bashkim vëllazërimit mes viktimës dhe vrasësit historik.

Duke u ballafaquar me nevojën imediate të ndryshimit të përnjëhershëm ideologjik, kapitalizmi neoliberal në Ballkan ndërmori hapin e patjetërsueshëm të aleancës me nacionalizmin,i cili për shkak të afinitetit të të qenit edhe një pretendim i ri edhe i çliruar në të njëjtën kohë, do të mund të kontrabandonte ëndrrën neoliberale përmes ëndrrës nacionaliste. Popujt e Ballkanit e kanë të pamundur të zgjohen nga ëndrra neoliberale mu sepse atë e ëndërrojnë përmes ëndrrës nacionaliste dhe çdo zgjim i mundshëm relevant ndaj neoliberalizmit domosdo imponon zgjimin nga nacionalizmi.

Punëtorët e padrejtësuar, të papunët e dëshpëruar dhe studentët e pamundësuar e kanë të pamundur të ndërtojnë argumentin social në hapësirën e tejcopëtuar Ballkanike, sepse kapacitetet për ndryshim revolucionar në shtetet e veçanta janë tejet të kufizuara, ndërsa nga ana tjetër bashkimi dhe bashkëveprimi në nivel Ballkanik shantazhohet vazhdimisht nga narracioni nacional për viktimën dhe vrasësin historik.

Prandaj është i vlefshëm pretendimi se çdo grupim apo lëvizje progresive sociale në secilin shtet Ballkanik duhet të vendosë antinacionalizmin si premisë themelore mbi të cilën mund të mundësohet një argument i vërtetë social,i cili për të qenë i mundur duhet të pranojë vetë Ballkanin si instancën më të vogël të mundshme që ka kapacitet për të prodhuar ndryshimin social. Veprimin nën këtë instancë është i barabartë me ndryshimin që në teorinë e materializmit dialektik përshkruhet si një ndryshim i parëndësishëm sasior që sjell ndryshime fundamentale dhe substanciale (shembulli klasik i ndryshimit të shkaktuar nga një gradë celsius më shumë në ujin e nxehtë, që si rrjedhojë kalon në gjendje të avullt). Zbritja nën nivelin Ballkanik në atë shtetëror, në konditat ekzistuese Ballkanike (të ujit të nxehtë) është e barabartë me ndryshimin substancial nga argumenti i drejtë social në argumentin fashist nacional-socialit.

Nacionalizmi në Ballkan nuk duhet kuptuar si një veti primitive autentike e popujve të këtij regjioni, sepse ai nuk është një ide e përjetshme, por një potencial që varësisht nga praktika shoqërore mund të fuqizohet apo zvogëlohet deri në zhdukje. Duke pasur parasysh praktikën e pas viteve të nëntëdhjeta ne Ballkan, atë të eksploatimit të nacionalizmit nga ana e doktrinës neoliberale, ne duhet të kuptojmë që për të pasur një ballafaqim real me kapitalizmin në formën e tij të sotme neoliberale, së pari duhet të heqim qafe nacionalizmin.

Kundërshtimi ndaj neoliberalizmit që sot po gjëmon nëpër sheshet e botës, në Ballkan duhet të konsiston në sfidën emancipuese të kundërshtimit brenda grupit etnik. Hapi i parë në luftimin e padrejtësive sociale duhet të jetë ai i luftës me mitet nacionale. Kjo sepse përderisa Berisha mund të ketë fituar një sasi armiqsh për shkak të trajtimit që qeveria shqiptare u bën minatorëve të Bulqizës, ai ka fituar miliona adhurues me deklarimet për bashkimin e kombit.

Luftimi i narracioneve dhe miteve nacionaliste medoemos duhet të ndodhë sërish në instancën Ballkanike, mu sepse dobësimi i nacionalizmit në njërin shtet mund të shihet si rrezik në raport me atë që dominon në shtetin tjetër. Në solidaritet me okupimin e Wall Street, okupimi i Ballkanit sjell një risi, që përtej çdo rezonance me historinë e okupimeve të shteteve Ballkanike nga njëri-tjetri, nënkupton një okupim nga brenda, një okupim që thyen kufijtë nacionalist dhe që mundëson ndërtimin dhe përhapjen e argumentit social.

Para tre ditësh në Beograd ndërroi jetë publicisti dhe filozofi Radomir Konstatinovic, i cili në veprën e tij më të njohur 'Filozofia e nahisë' zbërthen të gjithë mitin nacional mbi të cilin ndërtohet shteti. Dhe shtetet Ballkanike janë të gjithë të ndërtuara mbi mite të tilla, të reja dhe të vjetra. Fuqia mobilizuese që këto mite kanë ndër popujt tonë parashtron përpara nesh sfidën e mobilizimit solidar që para vetes ka formacionet shtetërore si përfaqësuese të ekzistencës nacionale në Ballkan.

Në 'Filozofinë e Nahisë' Konstantinoviç thotë: 'Shpirti i nahisë, gjithnjë disi e gjen atë që nuk e kërkon, mirëpo tani ai këtë gjetje ia kthen historisë e cila është pamundësia e tij. Ai është i mundur për shkak se (më tej) është historikisht i pamundur.' Shpirti nacionalist i nahisë së Ballkanit është i pamundur mu sepse ai inaugurohet përmes mohimit që i bën historisë dhe këtu sfida nuk qëndron në ndryshimin e historisë, por në të qenit indiferent ndaj historisë. Ajo që duhet të ndryshojë është Ballkani, në fakt shpirti i tij i nahisë. E ky ndryshim mund të arrihet vetëm përmes okupimit. Okupo Ballkanin!

Mbi thelbin e rishikuar të demokracisë

Yllka Lamçe

Simptoma e zbrazjes së thelbit të koncepteve si "shteti demokratik", "shteti social", "solidariteti shoqëror" etj., është diagnostikuar prej kohësh tashmë, edhe në realitetin shqiptar. Po aq sa simptoma tjetër, ajo e përmbysjes së marrëdhënies që punëtorët kanë apo duhet të kenë me punën, shoqërinë ku ata përkasin dhe me vetë demokracinë.

Në preambulën e saj Kushtetuta shqiptare shprehet për "vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut...", ku spikasin terma si "shteti demokratik", "social", si dhe qëllimi i shtetit të përkufizuar kësisoj "për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut". Preambula vijon me "...zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror..." ku përsëri në asociimin e termave jo të rastësishëm si "dinjiteti njerëzor", "prosperiteti për të gjithë kombin", "mirëqenia" dhe "solidariteti shoqëror", në një interpretim të harmonizuar të tyre, lexohet një zgjedhje e qartë për llojin e shtetit, demokratik e social dhe dedikimin e këtij shtetit ndaj synimeve si prosperiteti për të gjithë kombin, mirëqenia dhe solidariteti shoqëror, që nuk mund të kuptohen përveçse nëpërmjet punës, funksionit të saj social-politik dhe mënyrës së organizimit të saj, me individin si epiqendër të sistemit.

Menjëherë pas preambulës, në Kreun I, dedikuar parimeve themelore kushtetuese, neni 3 rendit ndër të tjera "të drejtat e njeriut" dhe "drejtësinë sociale", si parime themelore mbi të cilat bazohet shteti. Të tjera dispozita që i referohen punës apo punëtorit hasen kryesisht në pjesën dedikuar të drejtave ekonomike, sociale e kulturore (nenet 49-52).

Pra siç shihet, Kushtetuta ka përvijuar marrëdhënien mes punës dhe demokracisë, demokracisë si formë politike dhe demokracisë si thelb i marrëdhënieve shoqërore, duke i njohur punës një rol themelor. Nuk mund të përkufizohet përndryshe si demokraci, qoftë në kuptimin formal, qoftë në atë substancial, sistemi ku ata që punojnë (një tjetër kategori kushtetuese) nuk gëzojnë të drejta, pavarësisht ekzistencës së partive politike, zgjedhjeve të lira, etj.

Sa më sipër, përforcohet edhe në konsideratë të parimit të barazisë së shtetasve sanksionuar në nenin 18 (ku ndër të tjera sanksionohet mosdiskriminimi, për shkak të gjendjes ekonomike apo sociale) dhe leximi në harmoni i tij me nenin 59 mbi objektivat socialë për punësimin që shteti synon të realizojë; të nenit 49 që shpall të drejtën e punës, të zgjedhjes së saj, të mbrojtjes shoqërore; të nenit 15 mbi detyrimin me të cilin Kushtetuta ngarkon organet e pushtetit publik në respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive themelore dhe në kontributin për realizimin e tyre.

E megjithë kuadrin e mësipërm kushtetues, gjendja e punëtorëve sot vazhdon të jetë dramatike, edhe për shkak të mënyrës se si këto të drejta artikulohen nga politikëbërësit në gjuhën e përditshme, ku nëpërmjet etiketimit të gabuar, shndërrohet edhe thelbi i tyre. Problem i cili prek edhe vetë konceptin e demokracisë, koncept më se i inflacionuar në thelbin e tij. Prej kohësh tashmë, demokracia si ideal politik i shoqërive të zhvilluara dhe që kërkojnë të zhvillohen, ka pësuar një deformim në kuptimin e saj, duke bërë të flitet për "post-demokraci", "demokraci-fasadë", "demokraturë", apo "demokraci pa demokraci". Termat në fjalë, përtej groteskut që mund të përçojnë në momentin e parë, dëshmojnë në të vërtetë një realitet të hidhur të demokracisë e cila është shndërruar në një kategori që mund të mirëpresë edhe më antidemokratikun e koncepteve. Kështu mjafton të kujtohen përdorimet e termit demokraci nga liderët autoritarë, totalitarë, post-totalitarë, apo pseudo-demokratë, në emër të së cilës janë justifikuar sa e sa paligjshmëri. Vetë fjalori i demokracisë (terma si "liria", "drejtësia", "barazia", "progresi", "zhvillimi", "ligji", "kushtetuta") marrin domethënie të dyshimta, të diskutueshme, relative, në varësi të shqiptuesit të tyre dhe pozicionimit të tij, lart apo poshtë në shkallën e pushtetit social. Sepse ajo që pritej të ishte në anën e të përjashtuarve dhe më të dobtëve, duket se është kthyer në monedhën e preferuar të këmbimit të kujt pretendohej të kufizonte.

E njëjta gjë duket se po verifikohet edhe me termin "punë", zvenitjen dhe regresin e thelbit të tij. Përdorimi gjithnjë e më i pakët, zëvendësimi nga të tjera kategori abstrakte (si p.sh. "punësimi") ndikon në vetë rolin social-politik të tij, për sa kohë humb elementi "personal" që do të duhej ta karakterizonte, në konsideratë të subjekteve të cilave u drejtohet, punëtorëve, qenie njerëzore prej mishi dhe gjaku.

Në fakt "puna" dhe "punëtorët" shprehin koncepte të ndryshme. Puna është një nga elementët e procesit prodhues, që i nënshtrohet ligjeve të procesit në fjalë. Punëtorët janë persona të cilët, përtej kategorizimit thjeshtues të ofruesve të shërbimeve, janë gjithashtu titullarë të drejtash dhe detyrimesh. Ndryshimi i terminologjisë, ndikon në ndryshimin e vlerave themelore. Anulimi i elementit "personalizues" që lidh punën me qenien njerëzore, çon në zëvendësimin e një kushti real me një status real. E njëjta gjë mund të thuhet për "edukimin" që zëvendëson "studentët", apo të tjera kategori të llojit. Të drejtat dhe liritë u referohen subjekteve të caktuara si punëtorëve, studentëve, të sëmurëve dhe jo punës, apo edukimit apo shëndetësisë.

E ndërkohë që konceptet pësojnë këto ndryshime, në kuadrin kur punëdhënësi logjikon sipas rregullave të ekonomisë së tregut, të përfitimit të atypëratyshëm, në një treg ku ai vetë kërkon të mbijetojë, politika pritet të ketë më tepër vizion e të shohë më larg. Ajo politikë e cila përveçse keqartikulon problemet duke i shmangur dhe jo duke u përballur me to, i është dorëzuar gjithashtu forcës së faktit të kryer, e paaftë të mendojë apo të marrë vendime.

Çështja është nëse politika e konsideron veten përgjegjëse për sa më sipër. Kushtetuta thotë se politika nuk mund të jetë indiferente dhe e papërgjegjshme, megjithëse po ndodh pikërisht e kundërta.

Kushtetuta kërkon që nëpërmjet punës të krijohet lidhja e vërtetë sociale. Realizimi i të drejtave themelore të punëtorit, jo si palë e çfarëdoshme e një marrëdhënieje kontraktore, por si qenie njerëzore që zgjedh punën si program të jetës së vet, që nga puna pret identitet, të ardhura, siguri, pra faktorë kostitutivë të jetës dhe personalitetit të vet ridhënia e kuptimit që kanë dhe duhet të kenë këtyre të drejtave. Ridhënia e kuptimit të mirëfilltë demokracisë. Kjo do të ishte sfida.



gazeta
E mërkurë, 2 Nëntor 2011

Alain Badiou-ja ose dhuna e tërheqjes

SLAVOJ ZIZEK – NË MBROJTJE TË KAUZAVE TË HUMBURA V

Cila tërheqje?

(Vijon nga numri i kaluar)
Përzgjodhi dhe përktheu:
Arlind Qori

Duhet me pasë kujdes kur kundërshtarët nisin të flasin të njëjtën gjuhë apo të bashkëndajnë të njëjtën premisë – kjo pikë e bashkëndarë është zakonisht pika e tyre simptomatike. Le të marrim këtu tre filozofë bashkëkohorë aq të ndryshëm, sa Badiou-ja, Critchley dhe Negri: siç e kemi vënë re, ata bashkëndajnë premisën e fundit të kohës së politikës së partisë-shtet, qëllimi i mbramë i të cilës është marrja nën kontroll e aparatit shtetëror – këtej e tutje, politika duhet ta tërheqë veten nga fusha e shtetit, për të krijuar hapësira jashtë saj apo "vende të rezistencës". E anasjella e kësaj zhvendosjeje gjendet në pranimin e kapitalizmit si "sfond" të jetës sonë: mësimi që duhet nxjerrë nga rënia e shteteve komuniste është ai sipas të cilit, "të luftosh kapitalizmin" është e pakuptimtë...Pikërisht nga kjo hapësirë e bashkëndarë duhet "tërhequr" vetja: "rezistenca e paraqet veten si eksod apo si ikje jashtë botës."

Në një intervistë të kohëve të fundit, Alain Badiou-ja shfaqi bërthamën e diagnozës së tij politike mbi telashin tonë. Ai ja nis me vizatimin e një vije ndarëse dallimi midis komunizmit dhe marksizmit: ai ende e quan veten komunist ("Komunizëm, "në një kuptim gjinisor", do të thotë thjesht se gjithkush është i barabartë me gjithkënd tjetër brenda shumësisë dhe larmisë së funksioneve shoqërore"). "Mirëpo, marksizmi është tjetërçka." Bërthama e markzismit gjendet në atë që Lenini e ka quajtur "ABC-ja e komunizmit": "masat ndahen në klasa, klasat përfaqësohen nga partitë dhe partitë drejtohen nga udhëheqësit" – në ditët e sotme, diçka e tillë nuk qëndron: masat e çorganizuara të kapitalizmit global nuk ndahen më në klasa sipas mënyrës klasike marksiste. Kështu që, ndërkohë që detyrë mbetet ende organizimi politik i masave, diçka e tillë nuk mund të kryhet më sipas mënyrës së vjetër të partisë klasore.

Modeli i partisë së centralizuar bëri të mundur një formë të re pushteti që s'ishte tjetër veçse pushteti i vetë partisë. Tashmë gjendemi përballë asaj që unë e quaj "distancë nga Shteti". Kjo ndodh, pikësëpari, për shkak se çështja e pushtetit nuk është më "imediate": sot, askund nuk duket e mundshme "marrja e pushtetit" në kuptimin kryengritës të fjalës.

Këtu duhen vërejtur tre pika. E para, përkufizimi i dykuptimtë i komunizmi: barazi "brenda shumësisë dhe larmisë së funksioneve shoqërore". E dyta, nocioni i antagonizmit klasor thjesht si "masat ndahen në klasa" e redukton atë në një nënndarje brenda trupit shoqëror, duke injoruar kështu statusin e tij si çarje që i kalon tejpërtej krejt trupit shoqëror. E treta, cili është statusi i përpiktë i pamundësisë së marrjes revolucionare të pushtetit? A përbën kjo thjesht një prapakthim të përkohshëm, një shenjë sipas të cilës po jetojmë në një situatë jorevolucionare, apo shënon kufizimin e revolucionit sipas modelit të partisë-shtet? Badiou-ja preferon versionin e dytë.

Në këtë situatë të re, na nevojitet një formë e re e politikës, "politika e tërheqjes" apo procese politike që janë "të pavarura – 'të tërhequra' – nga pushteti shtetëror. Ndryshe nga forma kryengritëse e partisë, kjo politikë tërheqjeje nuk është menjëherë shkatërruese, antagoniste apo e militarizuar." Kjo politikë ndodh në distancë nga shteti dhe nuk "strukturoret ose polarizohet më sipas agjendës dhe rrjedhës kohore që përcaktohen nga shteti." Si duhet ta mendojmë këtë jashtësi nga shteti? Këtu, Badiou-ja parashtron dallimin e tij kyç konceptual, atë midis shkatërrimit dhe tërheqjes:

[tërheqja] nuk varet më nga ligjet mbizotëruese të realitetit politik të një situate. Megjithatë, ajo nuk reduktohet në shkatërrimin e këtyre ligjeve. Tërheqja mund t'i lërë në vend ligjet e situatës. Ajo çka bën tërheqja është të sjellë në jetë një pikë autonomie. Ajo përbën një mohim, veçse nuk mund të identifikohet me pjesën mirëfilli shkatërruese të mohimit. [...] Na nevojitet një "tërheqje origjinare" që të jetë e aftë të krijojë një hapësirë të re pavarësie dhe autonomie nga ligjet mbizotëruese të situatës.

Kategoria e nënkuptuar filozofike që Badiou-ja problematizon këtu është nocioni hegelian i "mohimit të përcaktuar", i një mohimi/shkatërrimi rezultati i të cilit nuk është zero:

Në të kundërt të Hegelit, për të cilin mohimi i mohimit krijon një pohim të ri, unë mendoj se duhet të themi se mohimi i sotëm, thënë tamam, nuk krijon ndonjë gjë të re. Sigurisht që ai e shkatërron të vjetrën, por nuk i jep jetë ndonjë krijese të re.

Kjo lidhje midis politikës revolucionare dhe dialektikës hegeliane është vendimtare: "ashtu sikundër partisë, e cila një herë e një kohë përbënte formën fitimtare të kryengritjes, sot i ka kaluar koha, e njëjta gjë ndodh me teorinë dialektike të mohimit." Për fat të keq, kjo e shtyn Badiou-në drejt pseudo-problemit të "përshtatjes dhe kalibrimit midis pjesës mirëfilli mohuese të mohimit dhe pjesës I që ai e quan 'tërheqëse'":

Ajo çka quaj "mohim i lehtë", pra reduktimi i politikës në kundërshti demokratike, mund të kuptohet si tërheqje që, meqenëse është shkëputur kaq shumë nga mohimi shkatërrues, nuk mund të dallohet më nga ajo çka Habermas-i quan "konsensus". Nga ana tjetër, gjithashtu jemi dëshmitarë të një përpjekjeje dëshpëruese për ruajtjen e shkatërrimit si figurë e kulluar e krijimit të së resë. Kjo simptomë shpesh herë mbart një dimension fetar dhe nihilist

Shkurtimisht, çështja është të gjendet masa e duhur ndërmjet tërheqjes së kulluar demokratike, e cila zhvishet nga potenciali i vet shkatërrues, dhe mohimit ("terrorist") shkatërrues në mënyrë të kulluar – këtu, problemi qëndron në faktin se kjo "ndarje e brendshme e mohimit" në aspektet shkatërruese dhe tërheqëse riprodhon saktësisht ndarjen së cilës nocioni hegelian i "mohimit të përcaktuar" u rrek t'i gjente zgjidhje. (Badiou-ja e di mirë se nuk duhet hequr dorë nga dhuna: në fakt, ajo duhet rikonceptuar si dhunë mbrojtëse apo si dhunë e hapësirës autonome të krijuar nga tërheqja, siç ndodh në rastin e mbrojtjes që i bëjnë zapatistët territoreve të tyre të çliruara.) Shembulli që jep Badiou-ja për këtë "masë të duhur" më shumë ngre pikëpyetje sesa jep përgjigje: ai i lëvizjes Solidarnost në Poloni e cila ushtroi

një dialektikë të re midis mjeteve të veprimit që zakonisht mendoheshin si mohuese – greva, demonstrata etj – dhe diçkaje si puna e krijimit të një hapësire autonomie nëpër fabrika. Objektiv nuk ishte marrja e pushtetit apo zëvendësimi i pushtetit ekzistues, por shtrëngimi i shtetit që ky i fundit të shpikte një marrëdhënie të re me punëtorët.

Megjithatë, arsyeja pse një eksperiment i tillë zgjati aq pak kohë, siç e vëren vetë Badiou-ja, është se ai luajti rolin e fazës së dytë të tre fazave të disidencës: (1) kritika e regjimit sipas vetë termave të tij ("Duam socializmin e vërtetë! – pra, qortimi që i drejtohej partisë sunduese ishte: "ju keni tradhtuar vetë rrënjët tuaja socialiste"); (2) kundërqortimit të partisë sunduese se kjo besnikëri ndaj socializmit ishte hipokrite, i pason pranimi i hapur: po, ne jemi jashtë fushës së ideologjisë sunduese socialiste, por gjithsesi ne nuk kërkojmë pushtet. Kërkojmë vetëm autonomi duke i shtuar kësaj kërkesën se ata që janë në pushtet të respektojnë disa rregulla etike elementare (të drejtat e njeriut etj); (3) qortimit nga ana e partisë sunduese se kjo mungesë interesi në marrjen e pushtetit është hipokrite apo se disidentët në të vërtetë duan pushtet, i pason pranimi i hapur: po, pse jo?! Ne duam pushtet...

Shembulli tjetër i Badiou-së, ai i hezbollahëve në Liban të cilët kanë një marrëdhënie të dykuptimtë me pushtetin shtetëror (marrin pjesë në të, por në të njëjtën kohë ruajnë një farë distance nga ai, çka ringjall diçka të ngjashme me nocionin e vjetër leninist të "pushtetit të dyfishtë" – gjë që për Leninin përbënte gjithashtu një taktikë të përkohshme e cila do t'i hapte më vonë rrugën marrjes së plotë të pushtetit), ngre një tjetër problem: atë të themeleve fetare të këtyre lëvizjeve. Badiou-ja mendon se "këto lëvizje kanë një kufizim të brendshëm për shkak të veçanësisë fetare." Mirëpo, a është një kufizim i tillë vetëm afatshkurtër, siç duket se mendon Badiou-ja, diçka që këto lëvizje do (duhet) ta kapërcejnë në proverbialen fazë "të dytë, më të lartë" të zhvillimit të tyre, kur ato do (duhet) ta kenë universalizuar vetveten? Badiou-ja ka të drejtë kur vëren se problemi këtu nuk qëndron tek feja si e tillë, por tek veçanësia e saj – dhe a mos përbën kjo veçanësi tashmë një kufizim fatal për këto lëvizje, ideologjia e të cilave merr një formë drejtpërsëdrejti kundër-iluministe?

Përgjigjja e duhur ndaj versionit badiouan të politikës sipas personazhit Bartleby duhet me qenë hegeliane: krejt problemi i "masës së duhur" është i rremë. Tërheqja është "mohimi i mohimit" (ose "mohimi i përcaktuar"). Me fjalë të tjera, në vend që të mohojë-shkatërrojë drejtpërdrejt pushtetin sundues, duke mbetur brenda fushës së tij, ajo rrënon pikërisht këtë fushë, duke çelur një hapësirë të re pozitive. Çështja është se ka tërheqje e tërheqje – vetë Badiou-ja bën një hap mbrapa në lëmin simptomatik e konceptual kur e cilëson pozicionin social-demokrat si tërheqje të kulluar: tërheqja social-demokrate nuk është fare tërheqje. Terroristët "nihilistë" janë ata që tërhiqen duke krijuar kështu hapësirën e tyre të identitetit fetar fundamentalist. Ndër ta, shkatërrimi radikal i mbivendoset tërheqjes radikale. Një tjetër tërheqje "e kulluar" është mbyllja në vetvete mediteuese e ndjekësve të Epokës së Re, çka krijon një hapësirë më vete duke e lënë ashtu siç është sferën e realitetit shoqëror. (Ekziston po ashtu edhe shkatërrimi i kulluar: shpërthimi i dhunës "së pakuptimtë", si ajo e djegies së makinave nëpër banlieues-të franceze në 2005.) Pra, kur ndodh që tërheqja të krijojë me të vërtetë hapësira të reja? E vetmja përgjigje e përshtatshme do të ishte: kur të rrënojë koordinatat e vetë formës sistemore nga e cila e tërheq veten, duke goditur kështu në pikën e "përdredhjes simptomatike" të saj. Përfytyroni proverbialen shtëpi letrash apo stivën e druve të cilët qëndrojnë bashkë në një mënyrë kaq komplekse, saqë sikur një letër apo copë druri e vetme të hiqet – të tërhiqet – krejt ndërtesa bie përtokë: ky është arti i vërtetë i tërheqjes.

Sillni ndër mend fabulën e romanit "Të shikuarit" të Saramago-s, në të cilin votuesit refuzojnë në mënyrë masive të votojnë dhe hedhin fletëvotimi të pavlefshme, duke shtënë në këtë mënyrë në panik krejt strukturën politike (bllokun sundues dhe opozitën): ky akt i vendosi ata në një situatë përgjegjësie radikale ndaj nënshtetasve të tyre. Një akti i tillë përbën tërheqjen në formën e vet më

të kulluar: një gjest i thjeshtë veçimi nga pjesëmarrja në ritualin legjitimues e bën pushtetin shtetëror të duket sikur gjendet pezull në ajër mbi greminë. Për shkak të faktit se aktet e tyre nuk mbulohen më nga legjitimimi demokratik, ata që janë në krye gjenden papritmas të zhveshur nga mundësia për t'iu kthyer protestuesve në këtë mënyrë: "Kush jeni ju që na kritikoni? Ne jemi qeveria e zgjedhur, dhe prandaj mund të bëjmë ç'të duam!" Meqenëse u mungon legjitimiteti, atyre u duhet ta fitojnë atë nëpërmjet rrugës së vështirë, asaj të veprave. Më kujtohen vitet e fundit të sundimit komunist në Slloveni: nuk kishte qeveri të etur të fitonte legjitimitet dhe të bënte diçka për popullin, apo të përpiqej t'i kënaqte të gjithë, pikërisht sepse komunistët mbanin një pushtet i cili – siç e dinin të gjithë, përfshirë këtu edhe vetë komunistët – nuk legjitimohej në mënyrë demokratike. Meqenëse e dinin se po u afrohej fundi, komunistët e dinin po ashtu se do të gjykoheshin ashpërsisht...

Këtu ngrihet një qortim i dukshëm: a nuk po ndodh e njëjta gjë sot me indiferencën dhe abstenimin në rritje të votues sve? Ata që mbajnë pushtetin nuk ndihen të kërcënuar nga fenomene të tilla; kështu që ku na qenka tehu subversiv këtu? Përgjigjja është se duhet të fokusohemi te Tjetri i madh: shumica e atyre që nuk votojnë nuk e bëjnë diçka të tillë si gjest aktiv proteste, por sipas mënyrës së të mbështeturit tek të tjerët – "Unë nuk votoj, por i var shpresat tek të tjerët që votojnë në vendin tim..." Mosvotimi bëhet akt kur ndikon Tjetrin e madh.

Pikërisht në këtë kuptim, tërheqja është tashmë "mohimi i mohimit" hegelian: mohimi i parë është shkatërrimi i drejtpërdrejtë. Ai "mohon"/shkatërron përmbajtjen pozitive së cilës i kundërvihet brenda së njëjtës fushë të bashkëndarë realiteti; tërheqja e mirëfilltë, përkundrazi, i ndryshon koordinatat e vetë fushës brenda së cilës ndodh lufta. Kjo pikë thelbësore humb në disa nga formulimet e Badiou-së. Peter Hallward-i ka tërhequr vëmendjen te shumësia e kuptimeve të "tërheqjes" badiouane – sikur ky nocion të përfshinte një "familje" vitgenshtajniane kuptimesh. Boshti kryesor qëndron midis tërheqjes "si me u veçu nga" (nga fusha e shtetit, për të krijuar një hapësirë vetjake) dhe tërheqjes si "reduktim në dallim minimal" (duke u zhvendosur nga shumësia kah antagonizmi bazik, e kështu duke vizatuar vijën reale ndarëse). Vështirësia e detyrës qëndron në kryerjen e një zhvendosjeje në të cilën këto dy dimensione mbivendosen.

Tërheqja që duhet kryer është ajo nga fusha hegjemonike e cila, njëkohësisht, ndërhyn forcërisht brenda kësaj fushe duke e reduktuar atë në dallimin e tij minimale mbyllës. Një tërheqje e tillë është e dhunshme në mënyrë të skajshme, madje edhe më e dhunshme se shkatërrim/pastrimi: ajo përbën një reduktim në dallimin minimal, në dallimin e pjesë(s)/jo-pjesës, 1 dhe 0, grupeve dhe proletariatit. Ajo nuk është vetëm një tërheqje e subjektit nga fusha hegjemonike, por një tërheqje e cila e ndikon dhunshëm vetë këtë fushë, duke nxjerrë zbuluar koordinatat e saj të vërteta. Një tërheqje e tillë nuk u shton një pozicion të tretë dy pozicioneve, tensioni midis të cilëve karakterizon fushën hegjemonike (kështu që të kemi tashmë, në krye të liberalizmit dhe fundamentalizmit , edhe politikën emancipuese majtiste e radikale); në vend të kësaj, ky term i tretë "e çnatyralizon" krejt fushën hegjemonike, duke nxjerrë në pah bashkëfajësinë e nëndheshme të poleve kundërshtare që e themelojnë atë.

Merrni rastin e Romeo dhe Xhuljetës së Shekspirit: këtu, kundërshtia hegjemonike është midis Kapuletëve dhe Montagëve – kjo është një kundërshti në rendin konkret të të Qenit. Pra, një çështje idiote që i përket një veçanësie, këtij apo atij klani familjar. Do të ishte e gabuar ta shndërroje këtë çështje në një "dallim minimal" apo t'ia nënrendisje kësaj të gjitha zgjedhjet e tjera si të ishte e vetmja zgjedhje që ja vlen me të vërtetë. Gjesti që bëjnë Romeo dhe Xhuljeta ndaj kësaj kundërshtie hegjemonike është pikërisht tërheqja: dashuria i veçon ata. Ata e tërheqin veten nga mbërthimi i kësaj kundërshtie, duke ndërtuar hapësirën e tyre të dashurisë e cila në çastin kur mishërohet në martesë, pra jo thjesht si aferë sekrete rregullshkelëse, trazon kundërshtinë hegjemonike. Ajo që duhet mbajtur shënim këtu është se një gjest tërheqës i tillë në emër të dashurisë "funksionon" vetëm në lidhje me dallimet "substanciale" të fushave të veçanta (etnike, fetare), dhe jo në lidhje me dallimet klasore: dallimet klasore janë "jo-tërheqëse". Prej tyre nuk mund të tërhiqesh sepse ato nuk janë dallime midis rajoneve të veçanta të qenies shoqërore, por i kalojnë tejpërtej krejt hapësirën shoqërore. Kur përballemi me një dallim klasor, ka vetëm dy zgjidhje për lidhjen dashurore. Domethënë, çifti duhet të zgjedhë: ose partneri nga klasa e ulët pranohet me mirësjellje në klasën e lartë, ose partneri nga klasa e ulët heq dorë nga klasa e tij ose e saj, duke bërë kështu një gjest solidariteti me klasën e poshtme.

Ja ku qëndron dilema e tërheqjes: a është tërheqje/veçimi që e braktis fushën nga e cila veçohet e paprekur (madje funksionon edhe si shtojcë e brendshme e saj, si në rastin e "tërheqjes" nga realiteti shoqëror i Vetes së vërtetë që propozon meditimi i ndjekësve të Epokës së Re); apo e trondit dhunshëm fushën nga e cila veçohet? Tërheqja e parë i shkon për shtat në mënyrë të përsosur biopolitikës pas-politike; cila do të ishte, pra, e kundërta e biopolitikës?

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Zizek dhe kriza e kapitalizmit

Agon Hamza

Kapitalizmi po i afrohet nivelit-zero apokaliptik – kjo është teza mbi të cilën fundamentohet njëri ndër librat e fundit të Slavoj Zizek, Living in the End Times. Zizek identifikon katër 'kalorës' që do të sjellin kapitalizmin në atë pikë: kriza ekologjike, revolucioni bio-gjenetik, problemet e pronësisë intelektuale dhe rritja eksplozive e ndarjeve dhe përjashtimeve sociale. Çka e bën të 'veçantë' qasjen e Zizek-ut në raport me qasjet e tjera anti-kapitaliste? Duke qenë njëri ndër filozofët më serioz dhe më konsekuent të komunizmit, ai e etabloi veten si 'kalorësi' i pestë në rrugëtimin anti-kapitalist. Por, cila është fatkeqësia e Zizek-ut dhe filozofisë së tij, në raport me 'mendjet' cinike gjithandej globit? Kudo që flitet për të dhe paraqitjet e tija publike, reagimi spontan publik është "oh, unë e dua shumë këtë njeri" – dhe kjo fjali pason me një seri fjalish të cilat janë negacion arrogant i asaj që Zizek e shkruan në librat e tij; ato janë e kundërta e qëndrimeve/tezave filozofike të Zizek-ut në domenin e politikës. Në këtë kontekst, lëvizja e vetme korrekte në raport me Zizek është që të pushojmë së dashuruari atë, dhe në vend të dashurisë, të fillojmë të lexojmë Zizek-un. Problemi që përmban kjo formë e dashurisë ndaj tij është (thënë në termet e tij) se ajo është 'dashuri decaff' – dashuri ndaj "komikut Zizek", dhe jo ndaj "filozofit komunist Zizek". Këtu është i tërë problemi Zizekian, ose thënë ndryshe, raporti ndërmjet Zizek-ut komik dhe Zizek-ut filozof është raport i papajtueshëm antagonist. Siç do të thoshte përsëri Zizek, arsyeja e vetme pse ai perceptohet dhe pranohet si komedian është më qëllim që të mos merret/kuptohet seriozisht. Por, çka do të thotë ta marrësh Zizek-un seriozisht?

Kapitalizmi i vonshëm global ka arritur në krizën e tij terminale. Kontradikat e brendshme të kapitalizmit janë zhvilluar në atë masë që koekzistenca e tyre përbrenda formacionit kapitalist të organizimit shoqëror është thjeshtë e pamundur. Në shoqëritë tona kapitaliste, ndarjet klasore janë gjithnjë e më të thella dhe ato vazhdimisht po thellohen, grupe të tëra shoqërore janë të përjashtuara nga jeta shoqëroro-politike, represioni shtetëror është në rritje të vazhdueshme, dhe si rrjedhojë, liritë dhe të drejtat individuale janë gjithnjë e më të limituara, e kështu me radhë, në anën tjetër, krizat e vazhdueshme në Eurozonë, kontinentin Amerikan, privatizimi i vazhdueshëm dhe brutal i asaj që Marxi e quante "intelekti i përgjithshëm" (sistemi i Bolonjës, resurset natyrore, etj), katastrofat e vazhdueshme ekologjike (nga rrjedha e naftës në SHBA, pluhuri vullkanik në Islandë, etj), manipulimet biogjenetike, janë shenja të vazhdueshme për faktin që gjërat nuk mund të vazhdojnë të jenë kështu siç janë. Në anën tjetër, filozofi amerikan Fredric Jameson jep definimin më të mirë të utopisë liberal-kapitaliste: sot është më lehtë të imagjinohet fundi i jetës në planetin tokë, se sa një ndryshim radikal në kapitalizëm. Kjo do të thotë që, të gjithë ne, mund të paramendojmë Tokën duke u goditura nga ndonjë asteroid, ndonjë katastrofë ekologjike (kujto filmat e vazhdueshëm pikërisht për çështje), dhe jeta në botë do përfundojë, mirëpo, sidoqoftë kapitalizmi do të vazhdojë të ekzistojë tutje. Kjo është utopia par excellence. Utopia është pikërisht ajo gjendje shoqërore ku mendohet se alternativat për vetveten janë inekzistence. Me fjalë të tjera, kësaj i thonë ideologji: forma më perfide e ideologjisë është ajo e cila e mohon vet ekzistencën e vet.

Në këtë kontekst, analiza e kapitalizmit duhet fokusuar në kontradiktat e brendshme të tij, duke e lokalizuar 'idenë e komunizmit' (Badiou) pikërisht në këto kontradikta. Me fjalë të tjera, analiza dhe studimi i kapitalizmit ka kuptim vetëm nga perspektiva e materializmit historik. Së këndejmi, nevoja për riaktualizimin e materializmit historik është e rëndësie kruciale. Çka do të thotë kjo? Materializmi historik nuk duhet perceptuar thjeshtë si narrativë imagjinare e Historisë dhe as shkencë pozitive e historisë si domen i qenies (realiteti social, ekonomik, etj). Materializmi historik është shkenca e historisë së vërtetë, si dhe kritika e ekonomisë politike si shkenca e së vërtetës/reales së kapitalizmit.

Në këtë kontekst, çka do të thotë të jesh antikapitalist sot prej perspektivës së materializmit historik? Ose, thënë ndryshe, a është e mjaftueshme të jesh (vetëm) antikapitalist?

Që nga viti 2008 kapitalizmi është në krizën e tij më të madhe strukturore ndonjëherë. Sistemi financiar kolapsoi, me miliona vende të punës u mbyllën, qindra mijëra njerëz mbetën pa shtëpi, dhe si pasojë filloi kampanja e ashtuquajtur e 'shkurtimeve buxhetore', e cila natyrisht, nënkupton shkurtimin e shpenzimeve në shkollim, universitete, shërbime publike, pensione, sigurime shëndetësore e sociale, etj, përderisa bankat (sektori financiar), korporatat dhe shtyllat e tjera mirëmbajtëse të kapitalizmit fituan me qindra miliarda euro/dollarë për të tejkaluar krizën. Formula është e thjeshtë: të varfrit dhe të shtypurit paguajnë (gjithmonë) për të pasurit, për ata të cilët vazhdojnë të jenë të pasur dhe të nxjerrin profitin nga eksploatimi i vazhdueshëm i të varfërve. Siç thotë një parullë e vjetër, ne jetojmë në një botë e cila është 'socializëm për të pasurit, dhe kapitalizëm për të varfrit'. Ose, siç do të thoshte Bertolt Brecht, 'çka është vjedhja/plaçkitja e një banke, në krahasim me hapjen e një banke të re?' A nuk është e njejtë situata me miliardat e derdhura në sistemin financiar bankar? Na thonë se kriza financiare nuk është problem strukturor i kapitalizmit, por një ç'rregullim aksidental. Na thonë se sistemi është tërësisht normal..

(VIJON NË FAQE 11)

gazeta
E mërkurë, 2 Nëntor 2011

S'ka qetësi në BE

Besnik Pula

Shikuar nga planeti Ballkan, BE-ja është më stabile, më e madhërishme dhe më e fuqishme se kurrë. Pritja me padurim e Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian nga shtetet që synojnë anëtarësimin në BE, për të shikuar se a po u jepet "bekimi" për të nisur procesin e anëtarësimit në këtë kolektiv (i cili, në fakt, iu aprovua Serbisë), jep shenjë për qëndrimin pothuajse të pandryshuar entuziast ndaj BE-së nga elitat politike të Ballkanit, përfshirë asaj në Kosovë, që prej një dekade e më shumë. Ndërkaq, kur shikon nga brenda, e sheh se BE-ja është buzë shpërthimit, si në pikëpamje ekonomike ashtu dhe politike. Nga ana ekonomike, kriza e borxheve sovrane po lë pa gjumë liderët evropianë, padyshim edhe drejtuesit e bankave më të mëdha evropiane, ndërsa ka zhytur jugun e Evropës në revolta sociale dhe veriun në kriza politike. Është një realitet i çuditshëm që, në momentin që gjithë evropianët kanë dyshime të thella në projektin evropian (që dëshmojnë sondazh pas sondazhi), besimi ndaj projektit në Ballkan ndër ballkansit (dhe veçanërisht shqiptarëve) është në kulm.

Kriza më imediate e BE-së sigurisht se nuk është vetë BE-ja por Eurozona, sado që çdo çarje brenda Eurozonës lëkund shtyllën themelore të unitetit evropian. Samiti i presidentit francez Nicholas Sarkozy dhe i kancelares gjermane Angela Merkel, pas negociatave të tensionuara dhe agonizuese, përfunduan në një marrëveshje – të tretin të radhës gjatë këtij viti – që synon të adresojë krizën e borxheve sovrane. Ky problem po ndjek si një hije e zezë politikën dhe ekonominë evropiane dhe rreziku nga orteku i kolapseve financiare anembanë Evropës dhe globit, dukej se mund të shtyhej muaj pas muaji, por kohëve të fundit gjithnjë e më shumë dukej buzë shpërthimit nga java në javë dhe dita në ditë, aq më tepër kur zjarri që po digjte Greqinë rrezikonte të kalonte edhe në Itali. Presioni për të vepruar ka qenë i jashtëzakonshëm, që duket se ktheu momentin drejt arritjes së një marrëveshjeje – që disa kritikë po e quajnë të paplotë – për t'u ballafaquar me problemin e krizës greke dhe mundësisë së përshkallëzimit të saj.

Sipas kësaj zgjidhjeje, liderët evropianë u dakorduan që të ngrenë kapacitetin e Mjetit për Stabilitet Financiar Evropian (EFSF) nga 400 miliardë në një bilion euro, të përgjysmojnë borxhin e Greqisë përmes presionit që një pjese të humbjes ta përballojë sektori bankar, si dhe të hartojnë një plan për rikapitalizimin e bankave evropiane që janë në rrezik. Kjo masë duket se nxiti optimizmin tek tregjet e kapitalit në Evropë dhe SHBA, që reaguan pozitivisht ndaj lajmit për marrëveshjen e re Merkel-Sarkozy, e që u përshëndet edhe nga presidenti amerikan Barack Obama. Një rezultat pozitiv i dalë nga procesi është fakti që shtetet më të fuqishme të Eurozonës më në fund u pajtuan me faktin se shkalla e rritjes së borxheve e shtetit grek është aq e lartë sa që është e pamundur që ai borxh të shlyhet. Në fakt, sipas disa parashikimeve, pavarësisht ndihmës nga BE-ja dhe shkurtimeve masive të shpenzimeve të brendshme, borxhi grek do të arrinte në mbi 200 për qind të BPV-së së vendit brenda tre vitesh. Sipas marrëveshjes aktuale, borxhi i Greqisë do të përgjysmohet, kjo me participimin e "vullnetshëm" të bankave nga të cilat kërkohet absorbimi i një pjese të humbjeve dhe të cilat në realitet aktualisht kërkojnë nga Greqia pagesa në shuma të pamundura për t'u përballuar nga ky vend. Në fakt, frika e bankave ka qenë gjithmonë mundësia e humbjes së likuiditetit të shtetit grek (me një fjalë, pamundësisë për të paguar), pasi që në kushtet aktuale përfitimi i tyre nga borxhi grek është enorm. Siç thotë një shprehje, bankat janë sikur ai personi që ta huazon çadrën kur është koha me diell, por që e kërkon që t'ia kthesh kur bie shi. Ky është pak a shumë raporti i Greqisë me investitorët që mbajnë bonot e saj.

Duhet theksuar se pyetja në tërë këtë lojë nervash nuk është niveli i borxheve të shteteve të veçanta, por tek "besimi" i tregjeve financiare ku blihen dhe shkëmbehen bonot, dhe që rrjedhimisht kanë mundësinë të përcaktojnë normat e interesit të kërkuara për bonot e shteteve të veçanta, të përcaktuara në bazë të rejtingut kreditor të secilit shtet. Për këtë ekziston një fakt shumë domethënës. Ndonëse shpesh përmendet fakti se borxhi aktual i Greqisë është mbi 180 për qind të BPV-së, të dhënat e përpiluara nga rrjeti CNBC tregojnë se në fakt, shkalla e borxheve e shteteve veriore evropiane është shumë herë më e lartë se ajo e Greqisë. Listën e borxhlinjve më të mëdhenj – gjithmonë në raport me BPV-në e tyre – e kryesojnë vendet si Britania e Madhe dhe Zvicra (mbi 400 për qind të BPV-së), Holanda (mbi 370 për qind), Belgjika (335 për qind), Danimarka (310 për qind), Suedia (280 për qind), Finlanda (270 për qind), Austria (260 për qind), Norvegjia dhe Franca (250 për qind). Madje edhe borxhi aktual i Gjermanisë, rreth 185 për qind të BPV-së së saj, është po aq sa ai i Greqisë dhe ai i Spanjës, dhe më i lartë se borxhi i Italisë, që shpesh përmendet si rrezik (që është rreth 146 për qind të BPV-së italiane). Këtu dhe qëndron hipokrizia e shteteve veriore evropiane, që tash e sa muaj i mbajnë leksione shteteve jugut se qenkan të papërgjegjshme me financat dhe shpenzimet publike. Në një rast, në kohën kur Greqisë po i bëheshin presione të mëdha për shkurtime të rënda buxheti, ministrja austriake e Financave e arsyetonte këtë duke folur në terma pothuajse raciste për "dorëshlirësinë" e grekëve, karshi prudencës, disiplinës dhe kujdesit financiar të shteteve të veriut, duke u thirrur në stereotipet e vjetra për evropianët veriorë si të disiplinuar, kursimtarë dhe racionalë me paratë e veta dhe ata të jugut si shpenzues të verbër që nuk mendojnë për të nesërmen. Ndërkaq, këto të dhëna dëshmojnë se trendi i rritjes së borxheve të shteteve evropiane nuk kishte asgjë të bënte me stereotipet e tilla kulturore, por se ishte një trend mbarë-evropian (dhe pjesë, padyshim, e trendit të financiarizimit neoliberal të ekonomive evropiane që është në themel të krizës aktuale), e aspak pjesë e dorëshlirësisë dhe iracionalitetit të evropianëve jugorë (dhe sidomos të grekëve ballkanas), kur shihet fare qartë se borxhet e shteteve të veriut të Evropës janë nga dy e trefish më të mëdha se sa ai i Greqisë, kur ato borxhe vlerësohen në përpjestim me vëllimin e ekonomisë së vendit përkatës.

Pse atëherë po dënohet Greqia? Meqenëse normat e paguara nga shtetet evropiane për borxhet e tyre nuk përcaktohen nga vetë ato, por nga tregjet financiare (dhe në radhe të parë sipas rejtingut kreditor të vlerësuar nga agjencitë si Standard and Poor's dhe Moody's), shtetet ngelin përfundimisht nën mëshirën e tyre. P.sh., një "bund" 10-vjeçar (bono e thesarit gjerman) aktualisht shitet në normën 2,17 për qind, që do të thotë se shteti gjerman blen kredi nga tregjet financiare me një normë jashtëzakonisht të ulët. Ndërkaq, një bono greke 10-vjeçare aktualisht shitet në normën 21,5 për qind, që domethënë se për të huazuar 100 euro, Gjermanisë i kushton 2 euro kurse Greqisë 21 euro. Masat e fundit të ndërmarra në samitin Merkel-Sarkozy nuk kanë të bëjnë me adresimin e borxheve evropiane në përgjithësi, por me krijimin e instrumenteve financiare evropiane që zbusin frikën e tregjeve financiare për rrezikun që paraqesin shtetet si Greqia dhe Italia, duke i siguruar tregjet se në rast të çdo dështimi financiar dhe devalvimi të mëtejmë të bonove, EFSF do të shërbejë si një lloj superthesari evropian që garanton thesaret e shteteve të veçanta.

Pyetja është nëse tregjet do të binden nga këto masa. Ngritja e kapacitetit të EFSF-së tashmë nuk ka të bëjë me Greqinë aq sa me Italinë dhe për financimin e saj BE-ja do të kërkojë mbështetje edhe nga Kina dhe shtetet tjera në zhvillim, që aktualisht gëzojnë rezerva të mëdha dollarësh. Mirëpo, pas një entuziazmi të shkurtër, se Italia vazhdon të paraqesë rrezik u tregua edhe në ankandin e së premtes së bonove italiane, në të cilën norma e bonove italiane u rrit në 4,93 për qind – shkalla më e lartë në dhjetë vitet e fundit. Kjo domethënë se rreziku i përhapjes së zjarrit nga kriza e borxheve sovrane nuk është zhdukur as pas masave të fundit, dhe se gjërat në BE nuk do të vazhdojnë të jenë të qeta për një kohë të shumë të gjatë.

(VIJON NGA FAQE 9)

...dhe tragjedia që ne po e përjetojmë është si rezultat i disa individëve lakmitarë. Por, a nuk është formacioni kapitalist i organizimit shoqëror (i bazuar në pronën private, interesin privat, profitin dhe eksploatimin) pikërisht shkaktari dhe arsyeja e korrupsionit, lakmisë, etj? Është e pamundur të mendosh kapitalizmin pa korrupsion, si element konstitutiv të tij. Në këtë kontekst, duhet riaktualizuar konceptin hegelian të negacionit të jashtëm dhe atij imanent. Negacioni i jashtëm (ose, eksternal) është p.sh. një hajn e vjedhë një mall të cilin unë e posedoj personalisht, përderisa negacioni imanent na tregon se vet pronësia është hajni në vetvete. A nuk vlen e njëjta në raport me përkrahjen e hatashme financiare për bankat dhe me korporatat? Në anën tjetër, kriza financiare globale na dëshmoi se ne nuk po jetojmë vetëm në një botë apokaliptike, siç ka dëshirë ta quajë Zizek-u, por për më tepër, bota jonë është botë shumë e errët. Konzervativët na thonë se kriza financiare erdh si rezultat i mungesës ose më saktë, të një figure atërore në botën tonë: dezintegrimi i figurës atërore shkaktoi krizën financiare dhe kjo tezë u sublimua më së miri në filmin The King's Speech. Në anën tjetër, liberalët dhe reaksionarët e tjerë na ftojnë për një kapitalizëm me "fytyrë njerëzore" (kujto thirrjen për 'socializëm me fytyrë njerëzore'). Këtu qëndron problemi i liberalëve në raport me organizimin kapitalist të shoqërisë njerëzore. Ata duan një decaff kapitalizëm: një kapitalizëm pa kriza, pa eksploatim, pra një kapitalizëm puritan, pa aksidentet e tij strukturore. Çka do të thotë kjo? Në Idealizmin e Madh Gjerman, nga Kanti e deri tek Fichte/Schelling/Hegel ekziston koncepti i "iluzionit metafizik". Kjo do të thotë që kalimi nëpër iluzionin është i domosdoshëm për të arritur tek e vërteta. Në këtë kontekst, detyrë e filozofisë ('kritike') është pahtësimi i gjendjes në të cilën iluzioni nuk është vetëm iluzion, nuk është aksident, por ai është strukturalisht i domosdoshëm. Lindja e iluzionit është e domosdoshme për shfaqjen e së vërtetës. A nuk është pikërisht kjo gjendja në të cilën ne jemi sot në domenin e ideologjisë? Qasja konzervative dhe ajo reaksionar-liberale është në domenin e iluzionit metafizik. Por, si përkthehet kjo ndryshe? Në filozofinë hegeliane ekziston koncepti i totalitetit: për Hegelin, totaliteti nuk nënkupton ekzistencën e një tërësie organike harmonike, përkundrazi, për Hegelin totaliteti do të thotë se në analizën e një fenomeni (p.sh. kapitalizmit) duhet përfshirë të gjitha shkarjet, çrregullimet, kontradiktat, përjashtimet e vet nocionit. D.m.th. kur shikohet një fenomen, analiza nuk duhet të përfshijë vetëm atë që shihet dhe që 'ti' e sheh, por edhe determinimet negative të tij (pra, atë që 'ti' nuk e sheh). Pra, nëse analizohet kapitalizmi në totalitetin e tij, ai nuk duhet të analizohet vetëm në nivelin e tij afirmativ (Perëndimi, liria liberal-demokratike, etj), por edhe në nivelin e tij negativ, p.sh. zhvillimi kapitalist në Kosovë. Analiza e totalitetit të kapitalizmit nuk e përjashton Kosovën si një vend i cili ende nuk ka ardhë në termet me të ashtuquajturat vlera liberal-parlamentare, vlerat e tregut të lirë, etj – por, Kosova si vend tërësisht i integruar në tregun global kapitalist, ekziston si një vend i tillë çfarë është pikërisht për shkak të "iluzioneve metafizike", për shkak të strukturës së kapitalizmit si fenomen total. Për të gjitha problemet shoqërore, politike, ekonomike e kulturore, shkaku duhet të shikohet (dhe të kërkohet) në kapitalizmin si premisë.

Dhe këtu fillon pjesa e dhimbshme e këtij tregimi: përderisa në gjithë botën, miliona njerëz janë ngritur kundër kapitalizmit dhe pasojave që ai i shkakton (korporatat, eksploatimit, varfërisë, dhunës e shtypjes, etj), ku shtetet e kanë vënë policinë në mbrojtje të kapitalizmit (sepse, kapitalizmi nuk po funksionon për të gjithë, por vetëm për 1%shin, siç do të thoshin protestuesit në Wall Street), ne në Kosovë ende besojmë në kapitalizëm. E duam shumë atë. Provincializmi politik e ideologjik na ka mbërthyer në iluzionin metafizik të situatës ku kapitalizmi "është e vetmja lojë në vend". Në këtë linjë të argumentimit, historia po na përsëritet: bota nuk mund të vazhdojë të jetë kështu siç është tani. Ndryshime radikale strukturore janë të domosdoshme. Njerëzit e botës gjithandej globit kanë inaguruar bashkimin kundër kapitalizmit, duke përfshirë edhe shumë popuj nga rajoni ynë. Tani, çështja mbetët në këtë pikë: a do të jemi kësaj herë agjentë të ndryshimeve globale, apo do të mbetemi spektatorë neutral ndaj tyre, sikurse përgjatë gjithë historisë sonë politike? Fati ynë kësaj radhe është në duart tona!

Aleanca kundër Plehrave

Blendi Salaj

A do të mund një bashkim qytetarësh të ndalë një qeveri të vendosur për të importuar plehra?

Të dielën e 23 tetorit në Tiranë u shpall krijimi i një Aleance qytetare kundër importimit të plehrave. Emri i Aleancës ndoshta metaforik. Politologu Blendi Kajsiu, i cili ka qenë vazhdimisht i angazhuar kundër këtij plani të qeverisë, bashkë me intelektualë të tjerë (Lubonja, Klosi) shpallën se do të organizohen për të bërë ç'të mundin në mënyrë që Ligji që hap rrugën për importin e mbetjeve në Shqipëri të mos hyjë në fuqi. Presidenti Topi refuzoi ta dekretojë këtë Ligj, me argumentin se në vend që të minimizojë ndikimin e plehrave në mjedis hap rrugën për më shumë mbeturina në vendin tonë të vogël. Presidenti u sulmua fortë politikisht nga Mazhoranca pikërisht pas këtij mosdekretimi. Aleanca kundër Importit të Plehrave, AKIP, argumenton se ky ligj është i rrezikshëm për Shqipërinë, e cila nuk ka as eksperitzën, as mjetet dhe as sipërfaqen gjeografike për t'i hyrë një biznesi të tillë me risqe të qarta për mjedisin dhe shëndetin.

Camorra dhe grupime të tjera mafioze janë lojtarë veteranë të lojës së plehrave, ndërsa zyrtarët shqiptarë janë lehtësisht të korruptueshëm ishte një prej shqetësimeve që z. Kajsiu shprehu në një intervistë për Radion Club FM. Skenari më i keq i kësaj historie parashikon që bashkë me tonelatat e plehrave të zakonshme, Mafia të fusë në Shqipëri lëndë toksike dhe mbetje të rrezikshme spitalore, të cilat kërcënojnë shëndetin e qytetarëve dhe mjedisin. Është e qartë se importi i mbetjeve nga vende të huaja bie në një kundërshtim të natyrshëm me planet e "Shqipërisë turistike" që shpallen shpesh nga Kryeministri. Anëtarët e Aleancës thonë se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për të rrëzuar këtë ligj, dhe më tej do të tentojnë një Referendum mbarëpopullor.

Rrezik paraqesin edhe mbetjet e mbetjeve. Këto janë mbetjet e plehrave të përpunuara, të cilave u janë marrë të gjitha elementët e dobishëm dhe tani kanë mbetur si lëndë të dekompozuara dy herë të cilat duhet të varrosen diku në nëntokën shqiptare. Rreziku i ndotjes së ujërave nëntokësorë nga të tilla materie është i lartë. Napoli, kryeqyteti italian i grumbullimit të plehrave ka një shkallë të sëmundjeve kancerogjene shumë më të lartë se mesatarja e Italisë.

Pyetjes se pse qeveria ndërmerr një nismë kaq antipopullore, që mund t'i kushtojë shtrenjtë politikisht, Blendi Kajsiu i përgjigjet se në opinionin e tij është "dëshpërimi financiar" që e detyron Berishën të mbledhë plehrat e botës. "Qeverisë i duhen para, për rroga, për investime publike, për zgjedhjet e ardhshme. Por unë mendoj se pikërisht kjo çështje do t'i kushtojë Berishës zgjedhjet në vitin 2013." – shton Kajsiu.

Megjithatë, jo të gjithë janë kundër importit të mbetjeve. Në editorialin e botuar në Gazetën MAPO, analisti pro qeverisë, Henri Çili shkruan se Aleanca Kundër Plehrave është vetëm një lëvizje e moralistëve laikë. Në editorial z. Çili argumenton se industria moderne është përgjigjja e duhur, pasi kjo bën të mundur që plehrat e importuara të trajtohen për të mos shkaktuar dëme në ambient. Por shkruesi i këtyre radhëve nuk ndihet fort i sigurt. Në rast se industria do ta kishte zgjidhur kaq paqësisht çështjen e mbetjeve, pse ka kaq shumë interes nga vendet e tjera për të eksportuar mbetjet jashtë territorit të tyre?

Një pjesë e njerëzve besojnë se bizneset që janë interesuar dhe kanë investuar në fabrika riciklimi plehrash ia kanë futur qeverisë të dyja këmbët në një këpucë dhe kërkojnë lëndën e parë (Plehrat) për të vënë në punë impiantet. Këta biznesmenë kanë sponsorizuar fushata elektorale dhe janë në të drejtën e tyre të kërkojnë kompensimin. Por problemi është se interesat e tyre shkojnë kundër interesave të miliona të tjerëve në këtë pak vend që kemi.

Gjithsesi, këtë javë pritet që ky Projektligj të hyjë edhe një herë në axhendën e kuvendit. Mazhoranca ka ndërmend ta votojë Pro dhe nuk shihet se ka mënyrë tjetër për ta ndalur përveç presionit publik për të mos votuar një ligj që vë në lojë shëndetin e fëmijëve në të ardhmen. Në mendimin tim modest kjo është një çështje që duhet të nxisë çdo qytetar të Shqipërisë, i majtë apo i djathtë. Deputetët dhe qeveritarët janë njerëzit që kemi zgjedhur dhe punësuar për të na përfaqësuar interesat. Dhe ashtu siç ndodh me çdo të punësuar që nuk u shërben interesave të punëdhënësit, edhe këta, që ngrenë kartona jeshilë për të kancerizuar të ardhmen e shqiptarëve, duhen përjashtuar nga puna në rastin më të parë.

gazeta
E mërkurë, 2 Nëntor 2011

ZOTI KRYEMINISTER! EDHE GOMERET DUAN TE JETOJNE.

Hervin Çuli

Mali I bardhe eshte 4418 metra, por nuk eshte hicgje. Everesti mali me I larte ne bote eshte 8890 metra, por nuk eshte hicgje. Mali me I larte ne bote eshte piramida e frikshme e plehrave qe menaxhohet nga kriminaliteti I organizuar. Ai eshte 15.887 metra, I vendosur ne nje siperfaqe prej 3 hektaresh. Qyteti im eshte sot kazani me I madh I plehrave ne te gjithe Europen. Ka te rinj 16 vjecare qe nuk e kane pare kurre Napolin e dikurshem, Napolin e bukur pa stoqet e medha te plehrave" . Jane keto fjalet e shkrimtarit Roberto Saviano, I denuar me vdekje nga Kamorra per te vertetat e tmershme qe ai ka shkruar dhe thene me emra konkrete, per ate cfare ndodh ne vendlindjen e tij, ne Napoli.

Kryeministri e mprehu shpaten edhe njehere per situaten! Ne daljen e fundit publike, kryeministri Berisha shkaterroi dy grupe te reja puciste. I pari ai I Aleances Kunder Importimit te Plehrave, dhe I dyti ai I Sali Shehut, kantidatit qe Presidenti I Republikes i ka propozuar parlamentit per drejtimin e Kontrollit te Larte te Shtetit. Sipas Kryeministrit, te dyja keto grupe drejtohen nga Edi Rama, qe tashme e ka Presidentin nje vegel ne duart e tij, e mund ta perdore kur dhe si ti doje qejfi. Meqenese personalisht bej pjese ne Grupin e Pare Pucist (jo ne ate te Sali Shehut), u ndjeva disi fajtor dhe e pashe me vend T'i shkruaj, e te perpiqem T'a sqaroj Kryeministrin tim, se ku I dihet! Aleanca Kunder Importimit te Plehrave Zoti Kryeminister, ju betohem, nuk ka asnje lidhje me Edi Ramen dhe me Bamir Topin. Ka mundesi qe rruget tona jane bashkuar ne nje qellim te perbashket, ne ate te frrenimt te futjes ne Shqiperi te malit te plehrave, por ju betohem Zoti Berisha, ne nuk kemi asnje lidhje me ata. Ne fund te fundit ne nuk kemi pune me keta individe qe s'po lene gje pa bere per T'ju marre pushtetin. Ne duam vetem qe Shqiperia te mos behet si Napoli, por ne asnje menyre qe larg qofte JU, mos jeni me Kryeminister. Dikush nga analistet Tuaj na akuzoi ne nje shkrim se themi gomarlleqe! Rrjedhimisht pak a shume na quajti gomere!!! Une personalisht nuk ja marr per fyerje,aq me teper qe e kam mik dhe e di se ma thote per te mire. Anetaret e tjere te Aleances mund te shprehen vete per kete problem. Analisti I Berishes mund te kete te drejte, pasi mendon se e ardhmja ne Zhvillimin e Qendrueshem te ketij vendi duhet te jete industria e riciklimit te plehrave, qe me siguri do t'i sjelle(sipas tij gjithmone) begatine e munguar ketij vendi. Aq me teper kur Kreu I OSBE-se ne Shqiperi, ne nje prononcim per shtyp, e quajti ligjin shume demokratik!!! Dhe kur flasin te jashmit(cuditerisht edhe per plehrat), nje popull I tere qe rezikon te kontaminohet, me sa duket duhet te mbylle gojen! Padyshim, ATA te huajt, me siguri e dine me mire!!! Por ca keqkuptime na lindin zoti Kryeminister. Prandaj, ndonese Ju fale zotit keni gjithmone te drejte, kjo nuk na ben ne te Aleances pale me armiqte dhe pucistet. Keto keqkuptime po I shpreh me disa pyetje qe me vrafte zoti po I pata me qellim te keq. Te gjitha pyetjet ndjekin logjikisht njera tjetren dhe kane shume pak nevoje per koment nga ana ime, sepse e kane perqjigjen brenda e jane te thjeshta dhe te kuptueshme per te gjithe. Padyshim kane nevoje per nje pergjigje nga JU, qe keni vene nje bast kaq te kushtueshem per popullin tuaj dhe per te ardhmen e tij.

Dakort! Juve (si keni deklaruar), si gjithmone ne keto 6 vjet qeverisje nuk do lejoni asnje lende te rezikshme te futet ne Shqiperi (e marrim per te vertete kete), dhe c''do mbetje qe do te kaloje kufirin do te jete sipas te gjitha rregullave. Si do ti kontrolloni stoqet e plehrave(ekodengjet) qe do vershojne ne Shqiperi, pasi ligji nuk parashikon volume te percaktuara per transportin e mbetjeve, dhe nuk e ndalon dot deponzitimin? Dua ti shtoj kesaj pyetje dhe nje fakt, thjesht per te qartesuar publikun per pyetjen time. Pertej detit paguhet shume nga qeverite perkatese per asgjesimin e mbetjeve. Fitimi nga ky asgjesim (transport jasht vendit ne kete rast) eshte ku e ku me I madh se sa nga transporti me qellim bisnesin e riciklimit. Transportuesi normalisht paguhet per ngarkesat qe dergon nga nje destinacion ne nje tjeter, dhe atij nuk I intereson aspak fati I asaj qe ka ne anije apo makine. Si t'ja bejme nese Shqiperia jone e perbashket Zoti Berisha, ne vend qe te shnderrohet ne nje destinacion importi per industrine ricikluese te na kthehet ne nje destinacion depozitimi per mbetjet, qe Italia (por jo vetem) ka nevoje ti largoje menjehere? Po kur Landfill-et tona (aktualisht I kemi jashte cdo standarti dhe pa ligj) te mos kene me vend, ku do ti cojme stoqet? Si ti bindim fshataret te mos I shesin tokat e tyre me cmime te leverdisshmenga varferia ne te cilen jetojme, e qe te interesuarit per te depozituar plehrat(s'po e quaj mafje se s''ma mban) kane kaq shume nevoje? Ne o I madhi kryeminister e dime qe Ti e ke ndershmerine dhe forcen qe lendet e rezikshme te mos guxojne ti afrohen kufirit shqiptar, por si t'ja bejme me ekodengjet e parezikshme qe mund ta kalojne kufirin edhe pse nuk plotesojne standartet per riciklim? Me thene te drejten une vete jam I bindur qe JU I keni hesapet e ndara me Kamorren apo Mafjen, por si t'ja bejme ketij Roberto Savianos qe thote se ne Shqiperi mafja ben cfare ti doje qejfi!!!??? Apo Saviano tani I denuar me vdekje eshte dhe te gjitha I thote nga inati? Apo eshte pucist edhe shkrimtari Italian? Edhe nja dy pyetje te fundit zoti kryeminister. Kreu I OSBE c'pune kishte me kete ligj? Ne jemi vend Sovran, dhe sipas Konventes se Bazelit I takon popullit dhe vetem popullit Shqiptar te vendose per importimin e plehrave! Edhe po nuk u pyet populli, na mjafton ndershmeria e provuar e fjales Suaj. Pse duhet te flase perpara Jush nje zyrtar qe nuk ka asnje lidhje ne misionin e tij me problemin e mbetjeve? Nuk besoj qe ky problem I plehrave te jete nje kusht per Shqiperine ne procesin integrues!!!???Po qe keshtu, te na e thone hapur qe ky vend do te jete koshi i plehrave per gjithe Europen, dhe ne e mbyllim gojen. Se ky popull pa personalitet- thote me vehte Hiresia Juaj- bageti eshte, ku ca jane dele te perendise qe perfaqesohen nga Ju, e ca te tjere gomerre qe manipulohen nga Edi Rama!!! Por edhe gomeret gjynah zoti kryeminister, edhe ata duan te jetojne. Si perfundim I nderuar zoti Berisha, na e fal ndonjehere qe nuk besojme tek ky shtet dhe tek Ju personalisht, qe po na mbroni, qepo na zhdukni korrupsionin, po na pastroni vendin, qe po na pasuroni e po na sillni lumturine me nje fjale. Ndodh qe nga padija T'ju keqkuptojme!

I nderuar lexues! Kete shkrim tragjikomik e fillova dhe po e mbaroj me citimin e shkrimtarit Roberto Saviano, I denuar me vdekje nga Kamorra. Kini mendjen per te lexuar me vemendje nje citim te tij vetem per ne shqiptaret.- ''Atje ku ka shume hapesire, ka shume biznes per mbeturinat. Dhe keshtu keshilla qe do ti jepja publikut shqiptar eshte: Kujdes! Cdo miniere do tju shnderrohet ne nje vendshkarkim mbeturinash, cdo fabrike e braktisur do tju shnderrohet ne nje magazine plehrash. Italia po sheh ne hapesiren shqiptare(dhe jo vetem Italia mafjoze) nje biznes per mbeturinat. Gjithmone do tju thone qe kot shqetesoheni, eshte nje hicgje. Nuk kemi c'te hame, eshte nje hicgje; na mungojne gjerat e domosdoshme, eshte nje hicgje; na mohojne te drejten per jeten, eshte nje hicgje; na heqin ajrin, eshte nje hicgje. Gjithnje eshte nje hicgje...Shikoni si jemi bere duke thene gjithnje keshtu, nje hicgje''.

Domosdoshmëria e alternativës sociale

Ermira Danaj

Fondi monetar ndërkombëtar i ka rekomanduar qeverisë shqiptare ditët e fundit, që të rrisë moshën e pensionit si dhe kontributet. Ky është bërë si një refren këto vitet e fundit, pra "mos rrisni pagat, mos rrisni pensionet, por rrisni moshën e pensionit dhe kontributin". Në fakt shprehja e saktë e cituar nga një e përditshme në Tiranë ishte "Qeveria shqiptare duhet të gjejë zgjidhje për të shkurtuar shpenzimet e larta për shërbimet sociale, sidomos ato për pensione". Nuk ka ndonjë çudi në këtë rekomandim të FMN, se sigurisht që nuk pritet që të FMN të thotë të kundërtën, për sa kohë në fokusin e saj është vetëm "qëndrueshmëria ekonomike", ulja e deficitit në pensione etj. Duket pak si paradoksale në fakt sepse qëndrueshmëria ekonomike nuk duhet të jetë qëndrueshmëri ekonomike per se, kot sa për të qenë aty, por duhet të jetë qëndrueshmëri ekonomike në funksion të një shoqërie të caktuar. Në fakt, kjo në shumicën e rasteve për të mos thënë shumicën ekstreme, rezulton të jetë vetëm në teori. Një përfaqësuesit të FMN, BB apo BQE, nuk duket se i intereson shumë qytetari shqiptar, por "deficiti i pensioneve", dhe aspak fare qytetari që merr apo do të marrë një pension. Por le të besojmë për një çast të vetëm që e gjitha kjo është për të mirën tonë, pra të qytetarëve. FMN dhe BB që prej fillimit të reformës se sigurimeve shoqërore kanë këmbëngulur në rritjen e moshës së pensionit, rritjen e kontributeve, privatizimin e skemës sikurse e sugjeruan edhe në vendet e Amerikës Latine, që më pas falimentuan rëndë. Megjithatë, të njëjtat sugjerime vinin dhe në vendet ish-socialiste. Në një raport të vitit 2007 të Bankës Botërore "From red to grey" vendoset theksi tek plakja e popullsisë në vendet ish-socialiste, ku mesa duket Shqipëria bën përjashtim sepse pavarësisht rënies së lindshmërisë, vazhdon të mbetet popullsi e re. Dhe tek ky raport lexojmë se reformat në Shqipëri të bazuara tek rritja e moshës se pensionit nuk janë të suksesshme sepse problemi nuk është mosha por papunësia dhe punësimi informal. Pra, për rreth 15 vjet thuhet vazhdimisht që duhet të rritet mosha e pensionit, si dhe kontributi për sigurimet shoqërore, dhe në fakt gjendja nuk ndryshon. Sepse është shumë e thjeshtë të kalosh një ligj për moshën e pensionit, si dhe të rrisësh kontributin. Në fund të fundit, të vetmit/et që e zbatojnë dhe që preken janë të punësuarit në sektorin publik, ndërkohë që sektori bujqësor ku të gjithë konsiderohen të vetëpunësuar vazhdon të mbetet problematik jo vetëm në lidhje me pensionet por të gjithë elementët e tjerë të mbrojtjes sociale, ndërsa sektori privat vazhdon të ketë një pjesë shumë të madhe informaliteti, pra punëtorësh të pambrojtur nga skemat e mbrojtjes sociale. Dhe sektori publik zë diçka rreth 16.7% e tregut të punës në Shqipëri, 43.2% e zë sektori bujqësor dhe 40.1% sektori privat jo-bujqësor.

Është shumë më e thjeshtë dhe për një qeveri, dhe nga eksperienca mund të themi qoftë kjo socialiste dhe qoftë kjo demokrate, të rrisë moshën e pensionit e ti bëjë qejfin FMN dhe BB sesa të shqetësohet se si mund të zhvillohen sektorët e ndryshëm në Shqipëri në mënyrë që të rritet punësimi, sesi mund të shtohet kontrolli (kjo në fakt dihet, por thjesht nuk zbatohet!!!!) ndaj tregut informal që punëtorët/et të mos mbahen në punë vetëm tre muajt e provës e pastaj të flaken në rrugë për tu zëvendësuar me disa tremujorë të tjerë, sesi mund të zhvillohet bujqësia e blegtoria duke qenë se aty jeton gjysma e popullsisë e lënë në fatin e saj, etj.

Shembullin e mos-shqetësimit për këto politikat e mësipërme e gjejmë tek procesi i privatizimit në Shqipëri, ku deri më tani asnjë nga këto privatizime (ashtu siç edhe pritej në fakt) nuk ka sjellë asgjë më tepër se sa disa lekë të përkohshme në buxhetin e shtetit. Por ama nuk ka rregulluar situatën e punonjësve, përkundrazi i ka flakur një pjesë në rrugë, nuk ka shërbyer për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit përkatës por e ka degraduar atë dhe më shumë, siç është rasti i minierave të kromit, shumë më i freskët dhe që s'ka nevojë për shumë komente. Në të gjithë këto vite nuk është bërë asgjë më tepër se mundësimi i pasurimit të jashtëzakonshëm të disa njerëzve dhe varfërimi i të tjerëve, i atyre që na u dashka të kontribuojnë më shumë për të rritur "qëndrueshmërinë ekonomike" të vendit, që duhet të bëjnë sakrificat më të mëdha dhe që iu duhet të vuajnë "reduktimin e buxhetit për programet sociale". Në fakt nuk ka se si të ndodhë ndryshe për sa kohë politikat dhe programet e "zhvillimit" i bëjnë këta të pasuruarit nëpërmjet këtyre politikave.

Shqetësimi më i madh është edhe kur sheh se perspektiva nuk është dhe aq e ndritshme nëse e sjellim situatën përsëri në terma shumë konkretë. Nga njëra anë kemi vlerësimet mbi arroret dhe shegët dhe boronicat, që nuk na bëjnë ndonjë të keqe, por me të cilat mund të merremi edhe pasi të jetë zgjidhur çështja e mbijetesës së mijëra familjeve në Shqipëri, çështja e spitaleve dhe qendrave shëndetësore nëpër qyteza e fshatra, çështja e shkollave në fshatrat malorë e fushorë, etj etj. Nga ana tjetër kemi shpalosjen e programit nëpërmjet twitterit. Është shumë bukur që politikanët shqiptarë komunikojnë nëpërmjet twitterit, por më bukur do të ishte nëse do të lexonim, në vend të editorialeve, ndonjë pjesë programi socialist, sikurse e do dhe emri i forcës politike. Do të ishte shumë mirë që të dihej njëherë e përgjithmonë nëse drejtuesit socialistë do të vendosin taksën progresive sapo të vijnë në pushtet apo jo, në mënyrë që super të pasurit të kontribuojnë më shumë, (ashtu siç iu takon dhe në funksion të shfrytëzimit që i kanë bërë burimeve njerëzore dhe natyrore), dhe në këtë mënyrë të shtohet investimi në shërbimet publike, që janë për të gjithë; nëse drejtuesit socialistët do të rregullojnë procesin e privatizimeve duke mos ia lënë gjithçka në dorë investitorëve të huaj që bëjnë çfarë iu do qejfi me minierën, fabrikën, etj; nëse drejtuesit socialistë do të merren më bujqësinë duke mos e lënë më të parcelizuar në një numër të stërmadh fermerësh që vetëm emrin kanë të madh, sepse të ardhurat nuk iu dalin as për mbijetesën e tyre të përditshme; nëse do të dënojnë në këdo sipërmarrës që mban punonjës pa kontratë e të pasiguruar; dhe nëse nuk do të rrisin moshën e pensionit dhe kontributin që fundos akoma dhe më shumë ata që janë në situatë dramatike, por do të nxisin punësimin, dhe do ti rikthehen parimeve të solidaritetit, siç do të duhej të ishte një parti të paktën social-demokrate.

Deri tani, në mënyra të ndryshme, njëherë më liberale, e më pas autoritaro-diktatoriale, qeveritë kanë punuar për përqendrimin e kapitalit e jo rishpërndarjen e tij. Ndaj ndryshimi sigurisht që nuk do të vijë nga ndryshimi i emrit të partisë që qeveris, por nga ndryshimi programor. Për sa kohë partitë me emra të ndryshëm kanë të njëjtën qasje ndaj taksës së sheshtë, ndaj privatizimit, ndaj zhvillimit të bujqësisë, ndaj mbrojtjes së prodhimit vendas, shumë pak do të ndryshojë nëse "D" zëvendësohet me "S", dhe përsëri pas disa vitesh do të kemi ndonjë propozim që të rritet mosha e pensionit derisa të barazohet me moshën e vdekjes e kështu mbase e zgjidhim deficitin në skemën e pensioneve.

Është shumë më e thjeshtë dhe për një qeveri, dhe nga eksperienca mund të themi qoftë kjo socialiste dhe qoftë kjo demokrate, të rrisë moshën e pensionit e ti bëjë qejfin FMN dhe BB sesa të shqetësohet se si mund të zhvillohen sektorët e ndryshëm në Shqipëri në mënyrë që të rritet punësimi,

gazeta
E mërkurë, 2 Nëntor 2011

Regjim me saktësi snajperi

Gentian Bala

Dy prej katër viktimave të 21 Janarit u qëlluan me armë preçizioni! Ndërsa nën bresherinë e armëve të gardës humbën jetën dy dhe u plagosen rreth njëqind të tjerë. Shumë prej tyre u mjekuan në shtëpi, jo sepse spitalet nuk ofrojnë higjenë dhe kushte të pranueshme, por sepse shtëpia ofron mbrojtje nga regjime që funksionojnë me saktësinë e një snajperi. Ky është bilanci i një dite proteste në Tiranë, bilanc të cilin të gjithë e kemi harruar, e kemi varrosur në memoriet tona. E megjithatë diçka mbetet edhe kur kemi tendencën të fshijmë horrorin nga kujtesa, mbetet instikti. Askush nuk ka për të dalë më në protesta, jo sepse ato e kryen misionin e tyre, jo sepse ka mbetur në zemrat e qytetarëve frika, ajo varroset bashkë me kujtesën. Por instiktivisht të gjithë do të ruhen, pikërisht nga plumbi i fshehtë, preçiz, i kurdisur me saktësi nga mëndje perverse pushtetarësh të babëzitur.

Në një regjim si ky i yni ku efikasiteti është i lartë dhe gabimi minimal, pushteti kalon në dy rrugë, një vertikale dhe një horizontale. Vertikal është pushteti që fillon lartë te kryeministri dhe zbret vertikalisht poshtë me shpejtësinë e forcës së rëndesës. Një shenjë prej Berishës ose një sms a një gjest, është i mjaftueshëm për t'u transfomuar në urdhër e më pas në ekzekutim (të urdhrit) nga ushtarët e bindur të pushtetit. Por akoma më marramendëse është shpejtësia e pushtetit horizontal. Zagarë të stërvitur dhe gjuhëvarur, të vëmendshëm e të gatshëm për çdo detyrë në shërbim të të zotit, sillen rrotull e kërkojnë gjurmë gjahu.

> Këta veprojnë me saktësinë e një sahati të prodhuar në Zvicër. Nuk gabojnë kurrë. Kanë mjetet dhe gjejnë kohën e duhur. Gjithmonë në krye të detyrës e në shërbim të pushtetit.

Këta veprojnë me saktësinë e një sahati të prodhuar në Zvicër. Nuk gabojnë kurrë. Kanë mjetet dhe gjejnë kohën e duhur. Gjithmonë në krye të detyrës e në shërbim të pushtetit. Ata për shembull mund të bëjnë sakrifica të paimagjinueshme për të shtuar qoftë edhe një votë në kutinë e tyre. Dhe për këtë nuk kanë nevojë të marrin urdhrin e padronit. Mund të pushojnë nga puna dy inspektore bashkiake, duke zbuluar edhe atribute boksierësh që rrahin gra. Ata mund të blejnë një televizion opozitar, një gazetë, një biznes, dhe ta çojnë në falimentim; median biznesin dhe veten e tyre. Mund të kërcënojnë një deputet fill pasi denocnoi aferën korruptive të një ministri për të cilën është krijuar një ministri apostafat për të zhvatur lekë në mënyrë të re. I referohemi Ministrisë së Genc Pollos, i cili duke notuar qetë mbi teorinë saliste të Shqipërisë në moshën e Internetit shet liçenca për fibra optike miqve të tij. Dhe këto veprime kërcënuese, telefonata, shantazhe, rrahje, i bëjnë pa marrë urdhër nga lart; kënaqësi perverse e të gjithëpushtetshmit.

Ndërsa populli struket në shtëpi, me një telekomandë në dorë, duke u ushqyer pikërisht me lajmet e zagarëve të lartpërmendur. Populli struket dhe ndjen dhembshuri për minatorët e Bulqizës, por kjo zgjat vetëm pak ditë, aq ditë sa e mendojnë mediat se ia vlen të merren me këtë temë. Populli trembet kur sheh si ekzekutohet gjyqtari në mes të qytetit, por nuk frikësohet shumë, të paktën dy ditë. Nën regjimin "e prosperitetit dhe rritjes ekonomike të barabartë me Gjermaninë", edhe çudia më e madhe nuk zgjat më tre ditë. Dy por edhe një ditë mjafton për të asimiluar një tronditje dhe për tu gatitur ndaj tjetrës. Është instikti i mbijetesës që shuan frikën, po i njëjti instikt që na largon nga sheshet.

Me saktësinë e një snajperi regjimi mund të zhdukë çdo zë opozitar të rrezikshëm, por edhe çdo zë jashtë përditshmërisë apatike ku qëllimisht e ka futur vendin. Regjimi të eleminon fizikisht fshehurazi, me snajper, nga godina e Jozefinës ose nga ajo e Berishës. Por sy më sy të eleminon shpresën dhe mundësinë për t'i ndryshuar gjërat. E kështu, të fshehur, në paqen e rreme të shtëpisë, larg shesheve, larg rrezikut, larg fokusit dhe shënjestrës së pagabueshme të regjimit snajper, asistojmë çdo ditë në shkërmoqjen e pandalshme të Shqipërisë.

Corine Lesnes (me Delphine Halgand), korrespondente e përhershme e Le Monde në SHBA

Studentët amerikanë të dërrmuar nga borxhet
Totali i huave arrin në 1 000 miliardë dollarë.
Barack Obama shpall masat

Një pankartë e vogël me shkrim dore qëndron mes tendave: "S'arrij ta besoj që po humbas shkollën për të protestuar kundër gjithë këtij korrupsioni". Christopher Buker, 25 vjeç, ka ardhur nga Cincinnati (Ohajo) për të marrë pjesë në lëvizjen Occupy Wall Street, e cila ka zgjedhur si vendqëndrim sheshin McPherson, vetëm disa qindra metra larg Shtëpisë së Bardhë në Washington.

I diplomuar në shkenca, Christopher ka marrë një kredi huaje prej 70 000 dollarësh (50 000 eurosh) për të paguar studimet. Pas përfundimit të tyre ka gjetur një punë modeste si asistent profesor nga e cila merr 15 000 dollarë në vit. "Nuk është normale që studentët të futen në borxhe për 20 vjet," -- proteston ai-- "në sistemin aktual ne jemi të detyruar të luajmë lojën e tyre, por në këtë mes nuk duhet të ketë lojë!"

Rasti i Christopher nuk është një rast i izoluar. Në tubimet e Occupy Wall Street që vazhdojnë në qytetet amerikane, kjo kërkesë vjen pareshtur: studentët janë të mbërthyer nga kreditë dhe huatë. Ato "nuk duhet të përdoren si burim përfitimi" denoncon një tjetër pankartë.

Administrata Obama i ka dëgjuar ankesat. Pa pritur që Kongresi të përshtasë legjislacionin përkatës, presidenti ka vendosur të reagojë me anë dekreti. Gjatë një turi në Perëndim, i cili përfundon të mërkurën më 26 tetor, gjatë një mbledhjeje në universitetin e Kolorados në Denver, ai duhej të propozonte masat në ndihmë të studentëve me borxhe, ashtu siç kish vepruar një ditë më parë në Las Vegas në ndihmë të pronarëve të kërcënuar nga shpronësimi. "Nuk mund të presim më!"-- e nisi ai fjalën, duke inauguruar kështu parullën e re të qeverisë së tij të irrituar nga manovrat penguese të republikanëve.

Në një vend ku hyrja në universitet konsiderohet si një prej shtyllave të "ëndrrës amerikane", shtimi i shpenzimeve shkollore, për klasën e mesme, ngjan me një makth.

Që prej vitit 2000, ato janë shtuar më tepër se dy-fish. Konkurrenca mes institucioneve shpie në shpenzime kolosale: nga pagat shumë të larta të profesorëve, deri te infrastrukturat sportive të denja për Lojërat Olimpike. Me ardhjen e krizës, fondet e derdhura nga shteti për universitetet publike janë pakësuar dhe universitetet, mungesat në fitimet i reflektojnë duke rritur tarifat shkollore, të cilat nuk janë të rregulluara me ligj. Për pasojë, familjeve u është dashur të marrin gjithnjë e më tepër kredi.

Pamundësia e shlyerjes

Sot, rreth dy të tretat e të diplomuarve janë në borxhe pas katër vitesh studimi dhe borxhi mesatar për student arrin në 23 000 dollarë. Fatura mund të shkojnë deri në 100 000 dollarë për studentët e masterit. Shuma e borxhit të huamarrjeve të studentëve do të arrijë në 1 000 miliardë dollarë deri në fund të vitit dhe ka kaluar tashmë shumën e borxhit që lidhet me shpenzimet me kartat e kreditit.

Mospagesat e borxhit studentor shënojnë një rritje historike. Të dhënat e fundit të publikuara nga Ministria e Arsimit tregojnë për 8,8% mosshlyerje në 2009 kundrejt 7,7% në 2008. "Pasojat e mosshlyerjes së kredive studentore janë katastrofike", shpjegon Julia Margetta Morgan nga Qendra për Progresin Amerikan pranë administratës Obama. Në ndryshim nga borxhet e tjera, huatë për studentët nuk mund të fshihen në rast falimentimi personal dhe qeveria mundet të bllokojë pagat, madje edhe derdhjet e Sigurimeve sociale.

> Sot, rreth dy të tretat e të diplomuarve janë në borxhe pas katër vitesh studimi dhe borxhi mesatar për student arrin në 23 000 dollarë. Fatura mund të shkojnë deri në 100 000 dollarë për studentët e masterit

Ekspertët i druhen pasojave në konsum. "Një i ri aktiv që ka borxhe të konsiderueshme për të shlyer, do ta shtyjë blerjen e makinës së tij të parë, shtëpisë së parë, madje edhe në datën e martesës", thotë Mark Kantrowitz, redaktor faqesh on-line të specializuara në huatë e studentëve.

Përktheu nga frëngjishtja:
Bora YLLI

gazeta
E mërkurë, 2 Nëntor 2011

Shqipëri & shqipërim i saj

nëpër prozën e Idlir Azizit

Krenar Zejno
(vijon nga numri i kaluar)



Një formë Mazokizmi i shton shkrimit të Azizit dobinë e asaj çka teksti synon – jo vetëm nga fakti se historia siç e beson Masoch rrjedh siç ngjizet prej femrave, kujtojmë inskenimin e katër personazheve tek "Katër ose një film i fundit mbi komunizmin tonë"-, por për nga trajta e dhunës verbale që çliron ndjesi, e prej këtej kuptimësi. Pastaj analiza prej arti kinetik që diku ka iluzionin optik, diku oralitetin fonetik, një lloj kriptoligjërimi që flet përmes copërave të veta si një bisht i këputur gjarpri, që duke ia njohur veçanësinë ripërtëritëse nuk mbetet i vështirë përfytyrimi imediat i korpusit zvarritës.

Ndaj rudimenteve të kinezërisë është vënë në funksion gjuhe qëllimshmëria e keqkuptimit, kërkuar po aq kinezërisht, sipas merakut të filozofisë tao-maoiste po nuk u turbullua nuk kthjellohet.

Terminologjia e sëmundjes dhe medicinës, e artikuluar diku edhe shkencërisht, i mundëson korpusit mendues të regjimit të na jepet i shtrirë, nderur krahë e kofshë, për t'i kryer discepsionin anatomik dhe nxjerrë në pah të përbrendëshmet. Prozë ku gjuha e shprish rendin 'eja n'radhë' të ligjërimit qëllimisht për të qenë faqja e sëmurë e sindromës kolektive dhe kundër retorikës pa voli, dhe duke e kundërshtuar atë po me armët e veta. Padyshim, është dituria dhe interventet teknike, aty-këtu edhe në blloqe të papërpunuara letrarisht, si me thënë të pafshehura si të tilla, që lejon analizën të plotësohet, porse pa u ndjerë inkursioni dituror si qëllim në vete, si objektiv. Më parë, diku më përpara në tekst, dhe krejt pa u ndjerë si synim, do të jetë sajuar sebepi, nën besimin se letërsia nuk se s'ka nevojë për diturinë, kjo dihet, por ama i lypset një farë budallallëku artistik për t'i rënë në të çështjes, ose për ta thirrur me emrin e saj. Pra, edhe afër atij përcaktimi cioranian se vetëm inteligjenca kërkon objektiva, budallallëku vetëm sebepe. Në një mision letrar të tillë, ku ajo çka së pari tentohet të grisen e shqyhen nga gjuha janë vetë objektivat e një tollovie si punë historie, nuk mund të ishin po objektivat ato që ngrehin artikulimin, por veç sebepet për të objektivizuar çështje. Shqipërinë e paushqyer dikur e të shqyer tani.

Dhe, tani, do propozoja një interval muzikor! Esenë "Tingujt e sërishtjes" që implikon muzikën dhe zhurmat e një shoqërie si paralajmëruese të së ardhmes së shoqërisë, shkruar kur u botua romani i parë, e kam mbyllur me: ...Dakord, dakord që Orfeu zbuste me muzë e muzikë kafshët dhe bimët; Amfioni, po me muzikë joshte peshqit, shkurt peshkonte; Ariusi i ngrehte me këngë muret e Tebes; Empedokli shëronte muzikalisht të marrët. Po kush do t'i bjerë qemanes në një vend ku orfejtë bëhen njësh me kafshë e trungje pemësh?! Kur Amfionët njëjtësohen me peshq, Ariusët bëhen njësh me muret e tyre, Empedoklët njehsohen me të shkarët!

Për ta përmbyllur në fund, mes një sociologjie psikotike siç i ka hije, me një si pjesë për orkestër nga romani i Idlir Azizit "Katër ose një film i fundit mbi komunizmin tonë". (Duke ndërmendur, sërish, që arti, letërsia - kujdestarë e ithtarë të veshit - e thonë më qartë se studimet hibride a psiko-sociologjia). Me një frazë të gjatë ku zëri bën atë avaz që arti e kthen si kolonë zanore të një "filmi" edhe për muzikën, atë që na bëzan të nesërmen. Po t'ia vëmë veshin:

"...dhe muzikë e përgjithshme dhe o zot i madh muzikë qejfi dhe pale pastaj muzikë kundër stresit dhe normal muzikë me taban dhe muzikë identiteti dhe muzikë integrimi dhe muzikë asocijimi dhe muzikë zhurme dhe muzikë provë për ekzistencën... provë ekzistence duke ia kaluar zhurmën tjetrit, edhe vetë janë të ndërtuar nga zhurma, të gjithë janë zhurma e njeri tjetrit, secili fillon bie dakord pastaj me këtë shëmtinë e përgjithshme... e ke parasysh, kjo shëmtia që është mbeturinë nga para nëntëdhjetës, ajo, kjo shëmtia pa kategori, domethënë që nuk është as e kundërta fare e bukurisë, një shëmti e monizimit apo ku di unë, po që vetëm në demokraci bëhet e dukshme, kjo shëmtia që mezi e mezi ka pritur një demokraci, që ka pritur vetëm një sistem tjetër nga ai ku është kultivuar që të dalë në pah, që të shfaqet krejt si është... ose më saktë një shëmti hibride, si simbiozë normalisht e asaj që nuk ka mundur të bëhet atëhere, me atë që është e vetkonsakruar tani nga të gjithë, në rang masiv, si ta shpjegoj unë tani, ajo shëmti, si, bie fjala, ku di unë, si ndonjë këngë e pas nëntëdhjetës, e ke parasysh, këngë nga këto pas nëntëdhjetës që ka dalë si kundërshtare e këngës së paranëntëdhjetës...

Alain Ehrenberg: "vuajtja njerëzve më e përhapur sot tenton të zhvillohet nisur nga një indigjestion mundësish gjithëfarësoji, në vend të një teprie të ndaluar si ishte dikur". E kjo molepsje e vuajtjes së këtushme, ky discepsion që tentohet të kryhet për ta radikuar vendin me infeksionin, kërkon bisturi e bombardime, brisqe e thika të mprehta. Që nuk është aq kollaj, si çdo operacion, aq më tepër tumoral, e thotë edhe fjalia e mbylljes së librit, a thua se gjer tani është gatitur, kruar e rruar nga leshi dhe qimet vendi i ndërhyrjes së kirurgjisë që bën gati pajisjet: me thikë, më thotë.

Njerëzimi po vetëvendos e instalon veten në monokulturë, po e riprodhon në masë siç kultivon zhardhokët e panxharit, lajmëron Levi-Strauss. Pikërisht, është, veç të tjerash, në këtë kuadriptik të Azizit edhe trajtimi i radikimit të së keqes, shpesh me anë të një përsëritjeje psallmoide model de Sade, e që insiston në të njëjtën rrahje çekani ndaj monokulturës (që pushteti e ndjell dhe mbjell për lehtësi korrjeje), si me thënë me të njëjtin shat prashitjeje e troshitjeje për të shkulur pastaj zhardhokun. Dhe duke shqyer strukturat gjuhësore e tekstuale monolotike përmes çarjeve prozodike. Kjo është strategjia e zgjedhur, ose e vetmja që i shkon për shtat stadit alla post-modern të së keqes këtu. Një skizo troshitëse kundër një frenezie retorike avdalle. Muze, aty real këtu imagjinar, brirësh e bishtash të specieve e bëmave reale e të paimagjinueshme të një territori njëzetetetëmijë metra katrori, dhe pickitave anë e rrotull e më tej, kur këto tunden e shkunden.

Ngërthimi në lëndën e romanit i inkursionit të shkencave politike, sociologjisë, filozofisë, historiografisë, antropologjisë, teknikat e përdorura, lëvizjet prej fuge e si një fugë, me mbartje prej lënde Melville, Conrad, Beckett, Joyce, Sade, vijnë si një gjetje më vete, sidomos në një letërsi si kjo e shqipes aktuale që, ende kaq vonë, nuk di të bujt modernitetin që ka zënë rrënjë qyshkur në letërsinë botërore.

Ndonjë tipar i veçantë, ndonëse jo lehtësisht në pah? Qerthulli pra, dhe fuga muzikale e centrifugale, tendenca për konceptualizim të një grade të panjohur më parë, jo sistemik më shumë sesa përmes asaj fallcos së konceptit, në të cilin siç e thotë Bataille dhe trajton shpesh Deleuze, qëndron edhe bukuria dhe efiçenca e vetë konceptit. Pra, paradoksi efikas i bombardimit të konceptit, troshitjes dhe marramendjes së tij, për të nxjerr në pah mrokullat e gjësë në shtratin e analizës dhe operacionit e, më tutje, reanimacionit: Kjo është mirësia e këtij aksioni edhe social-sanitar prej gjuhëzimi letrar, ku si shërbim parësor por edhe urgjence është caktuar të merret nën mbrojtje e trajtim të veçantë mësëpari gjuha...

(vijon në numrin e ardhshëm)